

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5893  
E mërkurë, 2 tetor 2019  
çmimi 0.40 €

## Pse Hasan Jashari ka vendosur t'i hyjë politikës dhe t'i bashkohet AKR-së



FAQE 8

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (PDK) KA VAZHDUAR TË MARTËN FUSHATËN ELEKTORALE NË QYTETIN E GJILANIT | FAQE 7

# NJERIU I TRUMPIT: VOTOJENI VESELIN, SE FORCON MIQËSINË ME AMERIKËN!

Ish-kreu i Drejtësisë së Administratës Trump, Matthew Whitaker, ka elektrizuar atmosferën në tubimin zgjedhor të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në qytetin e Gjilanit, pasi i ka dhënë mbështetje të martën kandidatit të PDK-së, Kadri Veseli, për kryeministër për zgjedhjet e 6 tetorit. Whitaker ka thënë se Veseli është kandidati për kryeministër që forcon miqësinë me Amerikën, kurse të tjerët e rrezikojnë këtë miqësi. Lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka falënderuar mysafirin, duke thënë se raporti në mes të Kosovës dhe Amerikës është më shumë sesa një lidhje mes dy shteteve të zakonshme



FLET PËR "EPOKËN E RE", SABRI KIÇMARI | FAQE 4-5

## KOHA E VETËVENDOSJES KA ARDHUR



Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për deputet, Sabri Kiçmari, beson se qytetarët e Kosovës janë përgatitur për ta bërë ndryshimin më 6 tetor. Në këtë

intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se ndryshimi është bërë imperativ kategorik i kohës. Sipas tij, ky ndryshim realizohet vetëm me Lëvizjen Vetëvendosje në

pushtet. Ai është shprehur i bindur se ka ardhur koha e Lëvizjes Vetëvendosje. Kiçmari ka theksuar se ka një klimë entuziazmi që i përshkon tubimet e Vetëvendosjes

## OPINION

ENTROFIA E FUSHATËS  
ZGJEDHORE, INSUFICIENCA E  
NJË POLITIKE ME PREMTIME  
BOSHE F. 5

Prof. dr. Hakif  
BAJRAMI



## AKTUALE



NDEROHET VEPRA E  
ISH-REKTORIT EJUP STATOVCI  
F. 11

FILLON VITI I RI AKADEMIK  
2019-2020 F. 11

## EKONOMI

NË VITET E ARDHSHE  
DO TË KETË NUMËR MË TË  
MADH TË TË MOSHUARVE F. 9

LIMAJ: PENSIONISTËT E  
KOSOVËS DO T'I TRAJTOJMË  
DINJITETSHËM F. 9



## SPORT

FERONIKELI PARALAJMËRON  
LLAPIN SE PIKËT MBESIN  
NË DRENAS F. 16

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Çurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Kryediplomati i Finlandës, Daçiçit: E papranueshme që po loboni kundër Kosovës



**BEOGRAD, 1 TETOR** - Pas vizitës në Kosovë, ministri i Punëve të Jashtme i Finlandës, Peka Havisto, ka udhëtuar drejt Beogradit, ku ka takuar homologun e vet serb, Ivica Daçiç. Havisto ka thënë se për Finlandën është e papranueshme që Serbia të llojë kundër shtetësisë së Republikës së Kosovës pasi, sipas tij, një gjë e tillë nuk i

kontribuon vazhdimin të dialogut, shkruan "Gazeta Express". Havisto ka thënë se edhe vendimi për taksën ka bërë që dialogu të ngeçë, ndërkohë ka shprehur gatishmërinë e Finlandës që ta ndihmojë Prishtinën dhe Beogradin për t'u kthyer në tavolinën e diskutimeve për normalizim të raporteve. Sipas tij, për të vazh-

duar dialogu duhet një vullnet i mirë nga të gjitha palët. Ministri finlandez ka thënë se mesazhin për heqjen e taksës e ka lënë edhe në Prishtinë gjatë vizitës, ndërkohë thotë se në Beograd do ta lë porosinë se lobimet për heqjet e njohjes së Republikës së Kosovës janë të papranueshme dhe kanë ndikim negativ në dialogun për normalizim të raporteve.

## Franca, si Gjermania, hapje të kushtëzuar të negociatave për Shqipërinë

Sipas burimeve zyrtare të Bashkimit Evropian, Franca pritet t'i bashkëngjitet qëndrimit gjerman për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shkupin dhe hapje të kushtëzuar të negociatave për Shqipërinë



**TIRANË, 1 TETOR** - Edhe pse vitin e kaluar presidenti Emmanuel Macron ishte ai që bllokoj hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, Franca pritet t'i bashkohet Gjermanisë, duke dhënë një "po" me kushte për vendin tonë.

Franca dhe Holanda do të japin qëndrimin e tyre për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut të mërkurën, gjatë takimit të ambasadorëve të përhershëm të Bashkimit Evropian në Bruksel. Duke cituar burime zyrtare të Bashkimit Evropian, "ABC News" shkruan se Franca do t'i bashkëngjitet qëndrimit gjerman për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shkupin dhe hapje të kushtëzuar të negociatave për Shqipërinë.

Takimi i sotëm (e mërkurë) i paraprin mbledhjes së ministrave të jashtëm të Bashkimit Evropian që zhvillohet më 15 tetor në Luksemburg, ku do të merret edhe vendimi për të të

dy vendet.

Heshtja e deritanishme e Macronit në lidhje me negociatat me Shqipërinë mund të shprehë, ndoshta, edhe një pakt të heshtur mes Gjermanisë dhe Francës, të cilat tanimë mund të arrijnë një marrëveshje kur bie fjala për Shqipërinë.

Bashkëpunëtori i lartë në Këshillin e Politikave të Demokratizimit në Berlin, Bodo Weber, thotë se Gjermania dhe Franca kanë gjetur tanimë një zgjidhje të mesme kur bie fjala për Shqipërinë. Analisti bën të ditur se Merkel dhe Macroni kanë arritur një pakt për një shkëputje të pjesshme, sipas së cilës, Shqipërisë iu vendosen disa kushte. Megjithatë, ndryshe nga Gjermania, Franca ka të ngjarë t'i kërkojë Shqipërisë të bëjë më shumë për t'i frenuar radhët e gjata të emigrantëve. Pasi vendosi nëntë kushte për t'i filluar negociatat me Shqipërinë, Ministria e Jashtme gjermane u ka bërë apel vendeve skeptike, si

Danimarka, Franca dhe Holanda, që t'i bashkohen vendimit të saj dhe të mos bëhen pengesë për dy vendet e Ballkanit Perëndimor.

Sipas raporteve, Gjermania po lobon me këto vende më radikale se ajo, me shpresën se kushtet e vëna mund të shërbejnë si një garanci për t'i bindur ato. Franca nuk e ka bërë ende publik qëndrimin, por Holanda ka dalë kundër integritit të

Shqipërisë.

Në komisionin për çështjet evropiane të Parlamentit holandez, ministri i Punëve të Jashtme, Stef Blok, është shprehur se nuk ka surpriza lidhur me hapjen e negociatave për Shqipërinë, pasi qëndrimi mbetet ai i verës. Ai i është referuar mocionit të aprovuar nga Parlamenti holandez në qershor të këtij viti kundër hapjes së negociatave të anëtarësimit me

Shqipërinë.

Stef Blok ka shtuar se Shqipëria do t'i hapë negociatat e anëtarësimit kur t'i përmbushë kushtet, ndërkohë që Maqedonia e Veriut duhet të vlerësohet në mënyrë të pavarur. Nëse Holanda i qëndron "jo"-së për Shqipërinë, atëherë Bashkimi Evropian pritet të shkojë drejt ndarjes së vendimmarrjes për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. (G. Sh).

## Meta në Estoni merr mbështetjen për procesin integruar në BE

**TIRANË, 1 TETOR** - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ndodhet për një vizitë zyrtare në Estoni, ku është takuar me zyrtarë të lartë të këtij vendi. Në takim me homologen Kersti Kaljulaid, Meta thotë se ka ndarë "të njëjtat vizione për sfidat e sigurisë evropiane, proceset e integritit euroatlantik dhe shtimin e bashkëpunimit dypalësh në të gjitha fushat me interes reciprok". "Vlerësova interesin e presidentes për rajonin tonë dhe mbështetjen e vazhdueshme për Kosovën. E

fitova për ta vizituar Shqipërinë, ftesë që e prit me kënaqësi", shpreh presidenti.

Presidentja estoneze ka theksuar se vendi i saj është një mbështetës i fortë i zgjerimit të BE-së, ndërkohë që kandidatët për t'u anëtarësuar duhet t'i vijojnë reformat në të mirë të qytetarëve të tyre. "Estonia është, ka qenë dhe do të jetë një mbështetëse e fortë e zgjerimit të BE-së. Mbajtja e derës hapur ka qenë gjithnjë vizion i politikës sonë të fqinjësisë dhe zgjerimit. Sigurisht

vendet që synojnë BE-në duhet t'i vijojnë reformat, por këto reformat sundimi i ligjit, përmirësimi i klimës për bizneset, respektimi i vlerave demokratike - nuk janë të nevojshme për BE-në, por për njerëzit e këtyre shteteve", është shprehur Kaljulaid.

Meta është takuar edhe me kreun e Parlamentit të Estonisë, Henn Polluaas, me të cilin ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërparlamentar dhe domosdoshmërinë për ta forcur atë.



Demokracia në Veprim (DnV) ka prezantuar të gjeturat e monitorimit për tri ditët e fundit të fushatës elektorale

# Partitë politike shpenzojnë mbi gjysmë milioni euro për tri ditë fushatë



Subjektet politike kanë shpenzuar mbi 500 mijë euro vetëm gjatë tri ditëve të fundit të fushatës zgjedhore. Këto të dhëna janë prezantuar të martën nga Demokracia në Veprim (DnV) në një konferencë për medie. Sipas këtyre të dhënave, PDK-ja ka shpenzuar 131 524 euro, LDK-ja 124 085, LV-ja 110 731, AAK-PSD 64 104, NISMA-AKR 41 957, Lista Serbe 18 011 dhe të tjera 14 150

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 1 TETOR - Demokracia në Veprim (DnV) të martën ka prezantuar të gjeturat e monitorimit për tri ditët e fundit të fushatës elektorale. Në një konferencë për medie vëzhguesit e DnV-së, Arben Kelmendi dhe Shpend Emini, kanë bërë me dije se subjektet politike kanë shpenzuar mbi 500 mijë euro në tri ditët e fundit të fushatës. Sipas këtyre të dhënave, PDK-ja ka shpenzuar 131 524 euro, LDK-ja 124 085, LV-ja 110 731, AAK-PSD 64 104, NISMA-AKR 41 957, Lista

Serbe 18 011 dhe të tjera 14 150 euro. Ata kanë treguar se në shifrën mbi 500 000 euro hyjnë shpenzimet e subjekteve politike që lidhen me organizimin e aktiviteteve zgjedhore të kalkuluara sipas çmimeve mesatare të tregut. Megjithatë, sipas tyre, këtu nuk përfshihen zbritjet e mundshme që operatorët ekonomikë ofrojnë për subjektet politike apo kandidatët për deputetë.

Kelmendi dhe Emini kanë treguar se në tri ditët e fundit të fushatës, 28-30 shtator, vëzhguesit e Demokracisë në Veprim (DnV) kanë vëzhguar 290

aktivitete të subjekteve politike në gjithë vendin në të cilat janë përfshirë rreth 80 mijë qytetarë. Ata kanë vlerësuar se gjuha e përdorur nga kandidatët në fushatë në përgjithësi ishte konform frymës së një fushate të lirë dhe konkurruese. Por, nuk kanë munguar ngjarjet kur kandidatët e subjekteve politike kanë drejtuar mesazhe fyese për kundërshtarët e tyre mbi baza partiake (22 raste).

Ndërsa vetëm në një ngjarje të organizuar nga PDK-ja në Fushë-Kosovë është evidentuar gjuhë e urrejtjes me bazë etnike. Po sipas tyre, pjesëmarrja e

përgjithshme e vajzave dhe grave në aktivitete zgjedhore në tri ditët e fundit të fushatës ishte rreth 24 për qind.

Afërsisht e njëjtë (23.6 %) ka qenë prania e vajzave dhe grave në cilësinë e folëseve në ngjarjet e subjekteve politike. DnV-ja ka vlerësuar se ky disproporcion tregon për qasjen e pabarabartë që gratë dhe vajzat kanë në fushatë në raport me konkurrentët nga gjinia e kundërt dhe kjo në përgjithësi po e bën garën zgjedhore më të disfavorshme për gratë. Të gjeturat e monitorimit tregojnë se është shënuar pjesëmarrje e shtuar e fëmijëve

në aktivitete zgjedhore. Rreth 1 700 fëmijë janë përfshirë në 99 aktiviteteve të vëzhguara, ndërsa pjesëmarrja e tyre në 9 raste ishte e organizuar. Sipas vëzhguesit të DnV-së, të hënën në Drenas dy shkollat e mesme kanë mbajtur mësim të shkurtuar për dy orë për shkak të tubimit të organizuar nga PDK-ja, i planifikuar të mbahej në orën 17:00. Gjithashtu, në këto tri ditë të fushatës ka pasur përdorim të resurseve publike, siç është rasti i veturave zyrtare ku është evidentuar në 9 aktivitete zgjedhore, ndërsa numri i veturave zyrtare në dispozicion të subjekteve arrin në 17. Sipas DnV-së, vetëm koalicioni AAK-PSD ka përdorur gjithsej 13 vetura në 5 ngjarje. Vëzhguesit e DnV-së kanë thënë se përdorimi i resurseve shtetërore, financiare e njerëzore nga subjektet politike në pushtet krijon avantazh të dallueshëm për ta dhe çrregullon parimin e garës së barabartë në mes të subjekteve, por edhe në mes të kandidatëve brenda subjekteve. Sipas tyre, në përgjithësi shfrytëzimi i resurseve publike për qëllime fushate e bën të cenueshëm integritetin dhe konkurrencën e drejtë në fushatë. Kurse sa iu përket shkeljeve të rregullave të fushatës, DnV-ja gjatë gjashtë ditëve të fushatës ka dorëzuar gjithsej 15 ankesa në PZAP, 10 prej të cilave janë miratuar (vlera e gjobave, 49 550 euro), 1 është refuzuar dhe 4 janë në pritje për shqyrtim. Ndërsa sa i përket mbulueshmërisë së aktiviteteve zgjedhore të subjekteve politike nga mediet, përkatësisht kronikat e televizioneve, të dhënat për periudhën 27-30 shtator, tregojnë që më së shumti mbulueshmëri ka pasur LDK me 106 minuta, pastaj VV me 91 minuta, AAK-PSD me 82, PDK me 80, Nisma AKR-PD me nga 79 minuta, Lista Serbe me 23 minuta, Fjala me 6, SLS 6 minuta dhe PEK me 5 dhe partitë nga minoritetet e tjera me vetëm 7 minuta.

## Tërnavë: Lajmet e rreme, kërcënim i demokracisë

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Fondacioni Konrad-Adenauer (KAS), në partneritet me Demokracia Plus (D+) kanë mbajtur tryezë diskutimi me temë "Lajmet e rreme, kërcënim i demokracisë".

Granit Tërnavë, menaxher i programeve (KAS), lajmet e rreme i quajti kërcënim i demokracisë, por tha se e rëndësishme është që mediat të mos u japin hapësirë këtyre lajmeve. Në prag të zgjedhjeve të 6 tetorit

Tërnavë ka kërkuar që këto lajme të mos përdoren nga liderët për vota.

Ndërsa Leart Hoxha, kryetar i bordit të D+, i cili moderoi këtë tryezë, prezantoi broshurën e kësaj organizate në të cilën paraqiten format e shpërndarjes së lajmeve të rreme.

Bardh Rugova, profesor në Departamentin e Gjuhës Shqipe në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", ka thënë se kërcënim i demokracisë

është më i madh sesa që mendohet. Sipas tij, po jetojmë në një shoqëri ku nuk ka mendim. "Në një anë e kemi lirinë e shprehjes, në anën tjetër e kemi fake news".

Kreshnik Gashi, kryeredaktor në Drejtësia në Kosovë, tha se sidomos tani gjatë fushatës zgjedhore po shihet një investim i madh i partive politike që po i përkrahin dhe fuqizojnë lajmet e rreme, sidomos përmes portaleve.

Driart Elshani, ekspert i sigurisë



kibernetike, vuri në pah nevojën e luftimit të fenomenit "fake news", duke thënë se kërkohet

bashkëpunim në rrafshin global dhe lokal për ta luftuar këtë fenomen.

Flet për "Epokën e re", Sabri Kiçmari

# Koha e Vetëvendosjes erdhi

Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për deputet, Sabri Kiçmari, beson se qytetarët e Kosovës janë përgatitur për ta bërë ndryshimin më 6 tetor. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se ndryshimi është bërë imperativ kategorik i kohës. Sipas tij, ky ndryshim realizohet vetëm me Lëvizjen Vetëvendosje në pushtet. Ai është shprehur i bindur se ka ardhur koha e Lëvizjes Vetëvendosje. Kiçmari ka theksuar se ka një klimë entuziazmi që i përshkon tubimet e Vetëvendosjes. "E ndiej se ky entuziazëm është i natyreshëm dhe jo instrumental", ka thënë Kiçmari

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për deputet, Sabri Kiçmari, është shprehur i bindur se më 6 tetor qytetarët e Kosovës do të votojnë për ndryshim. Ai ka thënë se tanimë ndryshimi është bërë imperativ kategorik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se ndryshimi realizohet vetëm me fitoren e Lëvizjes Vetëvendosje. "Ka një klimë entuziazmi që i përshkon tubimet e LV-së. E ndiej se ky entuziazëm është i natyreshëm dhe jo instrumental. Zhvillimet shoqërore i kanë disa ligjshmëri politike, që determinojnë ngjarje, kohë ose epoka të caktuara. Qytetarët e Republikës janë përgatitur për ta bërë ndryshimin. Ndryshimi është bërë imperativ kategorik. Dhe ndryshimi realizohet vetëm me Lëvizjen Vetëvendosje! Fitorja e LV-së është sinonim i këtij ndryshimi. Jam i bindur se ky ndryshim do të ndodhë më 6 tetor. Koha e Vetëvendosjes ka ardhur", ka thënë Kiçmari.

Ai ka deklaruar se LV-ja angazhohet për shtetin e së drejtës, shtetin zhvillimor dhe shtetin social. "Janë tri dallime themelore në mes të LV-së dhe subjekteve të tjera: programi i qartë dhe konkret, kuadri i pakorruptueshëm dhe etika politike, që e përshkon LV-në si lëvizje progresive shoqërore. Brenda LV-së kam gjetur një frymë politike progresive dhe një punë profesionale në komitete, që është e rrallë te subjektet e tjera", ka vlerësuar ai. Kiçmari ka shprehur optimizëm se do të arrijë të marrë vota të mjaftueshme për t'u bërë deputet në Kuvendin e Kosovës. "Rrethet intelektuale shqiptare, në Kosovë dhe Shqipëri, e njohin edhe mendimin tim teorik nga fusha e filozofisë, sociologjisë dhe shkencës politike. Mendoj se të gjitha këto do të kenë një reflektim në aktin vendimmarrës të qytetarëve të Kosovës për

mbështetjen e kandidaturës sime", ka thënë kandidati i LV-së për deputet.

**"Epoka e re":** Z. Kiçmari, si po ju shkon fushata zgjedhore dhe si po ju presin qytetarët?

**Kiçmari:** Është një fushatë shumë e qetë dhe me mjaft përmbajtje politike. Jemi gjithandej Kosovës me tubime të nivelit lokal dhe komunal. Ka një entuziazëm te qytetarët i cili shprehet përmes pjesëmarrjes së madhe të qytetarëve në tubime dhe thirrjeve për ndryshim. Ne po ua shpjegojmë programin politik, prioritetet, masat dhe veprimet e planifikuara të Lëvizjes Vetëvendosje të cilat po priten shumë mirë nga qytetarët.

**"Epoka e re":** Cilat janë gjasat për t'u bërë deputet?

**Kiçmari:** Qytetarët e Republikës së Kosovës më njohin mirë që nga mosha e rinisë. E kanë të njohur angazhimin tim në Lëvizjen Popullore të Kosovës në vitet 1980-1990 për krijimin e Republikës, e njohin mirë punën time si përfaqësues diplomatik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjatë kohës së luftës dhe rolin tim si Ambasador i Republikës së Kosovës në Austri dhe Australi, sidomos përmes përmbjlljes së procesit të njohjes së Republikës së Kosovës në kontinentin e Australisë. Rrethet intelektuale shqiptare, në Kosovë dhe në Shqipëri, e njohin edhe mendimin tim teorik nga fusha e filozofisë, sociologjisë dhe shkencës politike. Mendoj se të gjitha këto do të kenë një reflektim në aktin vendimmarrës të qytetarëve të Kosovës për mbështetjen e kandidaturës sime.

**"Epoka e re":** Cila është oferta kryesore e Lëvizjes Vetëvendosje për këto zgjedhje?

**Kiçmari:** LV-ja angazhohet për shtetin e së drejtës, shtetin zhvillimor dhe shtetin social. Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, për krijimin e



Fondit Sovran të Republikës dhe Bankës Zhvillimore, një skemë të punësimit të garantuar për të rinjtë, kontrata të garantuara për punëtorët dhe një ligj të ri mbrojtjeje për të punësuarit, për mbështetjen e fermerëve, për rimëkëmbjen e arsimit, duke e lidhur atë me nevojat e tregut të punës, heqjen e pagesave për të gjitha nivelet arsimore, sigurimin shëndetësor, votimin e bashkatdhetarëve tanë në ambasada dhe konsullata, mbështetjen e shkollës shqipe në mërgim, heqjen e pagesave të sigurimit për vetura për bashkatdhetarët në kufi, funksionalizimin e FSK-së dhe shërbim të obliguar ushtarak për të rinjtë, banim të përbalueshëm për 4 000 familje dhe një raport partneriteti me vendet e tjera duke investuar në profesionalizimin dhe rristurimin e shërbimit diplomatik.

**"Epoka e re":** Çka e dallon LV-në në këto zgjedhje nga subjektet e tjera politike?

**Kiçmari:** Janë tri dallime

themelore në mes të LV-së dhe subjekteve të tjera: programi i qartë dhe konkret, kuadri i pakorruptueshëm dhe etika politike që e përshkon LV-në si lëvizje progresive shoqërore. Brenda LV-së kam gjetur një frymë politike progresive dhe një punë profesionale në komitete, që është e rrallë te subjektet e tjera.

**"Epoka e re":** Parashikimet janë që LDK-ja, PDK-ja dhe LV-ja do të jenë pretendente kryesore për të fituar më 6 tetor. Sa sfiduese do të jetë për lëvizjen për ta arritur këtë qëllim?

**Kiçmari:** Ka një klimë entuziazmi që i përshkon tubimet e LV-së. E ndiej se ky entuziazëm është i natyreshëm dhe jo instrumental. Zhvillimet shoqërore i kanë disa ligjshmëri politike, që determinojnë ngjarje, kohë ose epoka të caktuara. Qytetarët e Republikës janë përgatitur për ta bërë ndryshimin. Ndryshimi është bërë imperativ kategorik. Dhe, ndryshimi

realizohet vetëm me Lëvizjen Vetëvendosje! Fitorja e LV-së është sinonim i këtij ndryshimi. Jam i bindur se ky ndryshim do të ndodhë më 6 tetor. Koha e Vetëvendosjes ka ardhur.

**"Epoka e re":** Nëse do t'i fitoni zgjedhjet, me kë do të qeverisni dhe cilat do të jenë prioritetet kryesore të qeverisë së re?

**Kiçmari:** Projekti i një koalicioni të përbashkët parazgjedhor me LDK-në dështoi përkundër një shkalle të lartë gjeroziteti të LV-së dhe kryetarit Albin Kurti. Pas zgjedhjeve do ta analizojmë me kujdes rezultatin zgjedhor, kryeministri në ardhje Albin Kurti do të marrë kontakt me partnerin eventual për koalicion dhe do ta ofrojë projektin tonë qeverisës. Reduktimi i numrit të ministrive, masa të shpejta antikorrupsion, procesi i Vetingut, racionalizimi i investimeve në rrugë dhe autostrada, investimi në industri dhe punësim, do të jenë prioritetet e qeverisë Kurti.

# HISTORIA DËSHMON QË VEPRIMET KANË MË SHUMË VLERË SE FJALËT

**Matt WHITAKER**

Unë kam lindur dhe jam rritur në Iowa. Kam mbaruar studimet në Universitetin e Iowas. Jam shumë i lumtur që shoh kaq shumë studentë nga Kosova që tani studiojnë në universitetin ku unë kam studiuar.

Ashtu siç e dini, shteti i Iowas është shumë krenar për partneritetin tonë ushtarak mes Gardës Kombëtare të Iowas dhe ushtrisë suaj. Qeveria e shtetit tim e konsideron Kosovën një partner të madh bujqësor. Ne duam më të mirën për Kosovën. Në fakt, Kosova është një shtet motër e shtetit tim të lindjes, Iowas.

Unë jam një republikan krenar. Unë kam shërbyer në dy administrata republikane, për Presidentin George W. Bush dhe Presidentin Donald J. Trump. Zgjedhjet në demokraci janë një e drejtë universale dhe një përgjegjësi. Zgjedhja e duhur, zgjedhja e vetme për përparim, për të gjithë ne, veçanërisht për amerikanët që po na shohin, është që të gjithë meritojmë një qeveri që punon për ne, jo për elitat dhe politikanët.

Partia Republikane është partia që mbron Kushtetutën e Amerikës dhe interesin e njerëzve gjithashtu. Secila palë merr vendime të ashpra, të guximshme dhe praktike në interes të përbashkët, të cilat, elitat dhe të ashtuquajturit njerëz të zgjuar nuk i marrin në konsideratë, por të gjithë ne e dimë se kjo është mënyra e vetme që të gjithë ne të përfaqësohemi dhe të sjellim përparim, prosperitet dhe siguri. Në zgjedhjet e SHBA-së për vitin 2016, amerikanët donin një ndryshim të vërtetë. Ne kishim nevojë për një reformator të vërtetë, i cili e kuptoi sesi qeveria e gjitha e humbi drejtimin. Elitat nuk e kuptuan këtë. Ne duhej të gjenim dikë që mund të bënte një ndryshim të vërtetë.

Presidenti Donald Trump e kuptoi që qeveria e dalë nga populli që punon për popullin, do të bëhej e mundur vetëm nëse dikush nga jashtë do të dërgohej për ta ndryshuar atë nga brenda. Ai u shpërfill, u përqesh, e megjithatë vazhdoi të luftojë dhe të bëjë fushatë. Asnjë pengesë nuk mund ta ndalte atë dhe lidhja e tij me



burrat, gratë, fermerët, ushtrinë, forcat e rendit dhe njerëzit e thjeshtë, jo elitat, do të vazhdojnë ta ndihmojnë atë të jetë presidenti më i fortë në historinë moderne.

U ndjeva i nderuar kur më kërkuan t'i bashkohem qeverisë së tij. Kam shërbyer si Shef i Stafit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe më pas u emërova nga Presidenti Trump si Kreu i Departamentit të Drejtësisë. Jo vetëm që ai është miku im, por më e rëndësishmja është që ai po e bën vendin tonë më të fortë dhe po e ndihmon botën.

Gjatë përvojës sime në qeveri, vizitova këtë rajon me një iniciativë antikorrupsion. Një përparësi e lartë e qeverisë amerikane është të sigurojë që vendet e huaja të veprojnë sipas ligjit. Në bashkëpunimin me vendet e tjera, ne respektojmë veprat dhe jo fjalët. Veprime, jo premtime. Dhe shpresojmë që miqtë dhe aleatët tanë të votojnë për kandidatë të fortë antikorrupsion, të cilët kanë provuar veten me vepra, jo me fjalë. Veprime, jo premtime.

Misioni im vazhdon të jetë të luftoj korrupsionin ndërkom-

bëtar sido që të mundem. Është e qartë për mua që këto zgjedhje kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit dhe krijimin e mundësive ekonomike për të gjithë në Kosovë.

Të dy këto synime do të realizohen duke pasur një Kryeministër që kërkon miqësinë dhe mbështetjen e SHBA-së. Kadri Veseli është personi i duhur për këtë gjë. Ai është kandidati më i fortë kundër korrupsionit, sepse ka angazhim të dëshmuar. Ai tashmë ka vepruar duke pastruar oborrin e shtëpisë së tij. Duke ndryshuar partinë e tij dhe duke i dhënë asaj një fillim të ri. Për dallim nga zgjedhja e vendit tim në 2016, ku ne duhej të zgjidhnim një person që vinte nga jashtë partisë, këtu ju keni dikë që ka ndërmarrë tashmë veprime konkrete kundër korrupsionit dhe që është një mik i vërtetë i Shteteve të Bashkuara. Pra, më duket se zgjedhja për popullin e Kosovës është mjaft e qartë dhe ju keni një vendim shumë të rëndësishëm për të marrë. Në këto votime, zgjedhja është midis një qeverie që do të forcojë bashkëpunimin me ne,

Shtetet e Bashkuara për të luftuar korrupsionin dhe për të zhvilluar ekonominë tuaj në mënyrë që të krijohet mirëqenie dhe sukses për të gjithë.

Mundësitë tuaja alternative përbëjnë një rrezik, bëhet fjalë për një qeveri të udhëhequr nga politikanë që mund ta izolojnë Kosovën dhe do të dëmtojnë marrëdhënien tuaj me ne. Për një qeveri që nuk mund ta luftojë korrupsionin.

Që të vijë këtu bizneset dhe investitorët amerikanë duhet të jenë në gjendje t'iu besojnë udhëheqësve dhe qeverive të qeverive të huaja. Parakusht është luftimi i korrupsionit si një kriter i domosdoshëm. Tani për tani, amerikanët kanë hezituar të investojnë në Kosovë për shkak të frikës që kanë prej korrupsionit.

Kadri Veseli nuk paraqet rrezik në këtë aspekt. Atij mund t'i besohet pastrimi i qeverisë, sepse ai tashmë ka dëshmuar se ka vullnet të veprojë kundër korrupsionit. Ai është një reformator.

Kadri Veseli është mik i Shteteve të Bashkuara dhe mik i Iowas. Prandaj, një qeveri e udhëhequr nga Kadri Veseli do të jetë lloji i

qeverisë me të cilën bizneset dhe investitorët amerikanë do të kishin dëshirë të bashkëpunonin.

Ky model ka pasur sukses më parë në vendet e tjera dhe do të funksionojë këtu.

Më duket se e vetmja rrugë për të ecur përpara është përzgjedhja e kandidatit të vetëm që është luftëtar. E dikujt që është njeri i veprimit dhe di të përballet me modelet e vjetra të qeverisjes, përfshirë edhe ndaj partisë së vet, kur vjen fjala për të shkaktuar prosperitet dhe sjellë ndryshim të mirëfilltë në vend. Këtu bëhet fjalë për PDK-në dhe Kadri Veselin.

Ju falënderoj për këtë përvojë. Ju falënderoj që më dhatë mundësinë që të shpjegoj perspektiven time.

Por, më e rëndësishmja, shpresoj se ju do të bëni zgjedhjen e duhur. Sepse, pres me entuziazëm që vendi juaj të ketë një sukses.

Zoti e bekoftë Amerikën. Zoti e bekoftë Kosovën. Dhe Zoti na bekoftë të gjithëve.

Faleminderit.

**(Ky fjalim është mbajtur në hapjen e fushatës elektorale të PDK-së në Gjilan)**

# Haradinaj: Vitia është partnere e koalicionit AAK-PSD për Kosovën që i del zot vetes

PRISHTINË, 1 TETOR - Kandidati për kryeministër nga radhët e koalicionit AAK-PSD, Ramush Haradinaj, së bashku me partnerët e vet, të martën ka mbajtur tubim elektorale në Viti. Ai ka thënë se Viti është partnere e koalicionit AAK-PSD për Kosovën që i del zot vetes në tërësinë e saj. "Anamorava njihen si kryengritës të hershëm për liri dhe të vendosur në mbrojtje të saj. Në Viti sot ndjeva krahun e fuqishëm të këtyre

njerëzve trima dhe punëtorë. Viti është partnere e koalicionit AAK-PSD, për Kosovën që i del zot vetes në tërësinë e saj", ka deklaruar Haradinaj. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve të kësaj ane që më 6 tetor të votojnë për numrin 119 dhe koalicionin AAK-PSD. Sipas tij, zgjedhjet e 6 tetorit do të jenë referendum për shtet. Duke folur për autostrada, ai ka thënë se duhet të punohet që Viti të mos mbetet e izoluar si dhe ka premtuar rritje për sub-

vencione. "Do ta heqim akcizën për naftë për çdo familje fermere që e punon tokën. Kemi paraparë rritje të investimeve kapitale", ka deklaruar Haradinaj. Ai ka thënë se qeveria e ardhshme do t'i rritë pagat nga 10 për qind çdo vit, do t'i realizojë premtimet për dhënie të shtesave për fëmijë dhe do ta zhvillojë vendin. Koalicioni AAK-PSD ka vazhduar fushatën zgjedhore edhe në Gjilan dhe në Lipjan.



## Osmani: Më 6 tetor përfundon sundimi i Kosovës nga krimi dhe korrupsioni

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Kandidatja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryeministër, Vjosa Osmani, ka thënë se me fitoren e LDK-së do të përfundojë epoka e sundimit të Kosovës nga krimi dhe korrupsioni. Në një tubim elektorale në Istog ajo ka deklaruar se më 6 tetor do të shkojnë në opozitë ata që e kanë vjedhur besimin e qytetarëve. "Fitorja e LDK-së i dërgon në opozitë sundimtarët që kanë vjedhur besimin tuaj dhe po jua ofrojnë paratë e vjedhura për ta blerë besimin tuaj. Praktika e vendeve totalitare ka treguar që sundimtarët e mbajnë popullin e varfër për ta sunduar më lehtë, por kjo praktikë përfundon më 6 tetor, me votën e lirë të qytetarëve të Kosovës dhe fitoren tonë", ka thënë Osmani.



Ajo ka deklaruar se fitorja e LDK-së më 6 tetor do të jetë lajm i mirë për Kosovën dhe aleatët e saj. "Do t'i tregojmë botës se Kosova nuk është vend i krimit të organizuar, nuk është vend i korrupsionit e

nuk është vend i haraçit. Unë kam ardhur sot për të lidhur një besë të re. Lidhja Demokratike e Kosovës është bashkuar si kurrë më parë për t'ua dhënë qytetarëve të Kosovës qeverisjen që ata meritojnë. LDK-ja është alternativa e vetme që ka dëshmuar dhe që garanton shkapjen e shtetit. Lufton krimin e korrupsionin dhe e vendos sundimin e rendit dhe të ligjit", është shprehur Osmani. Sipas saj, më 6 tetor do të ndodhë çlirimi i dytë i Kosovës. "Kosova nuk ka kohë për të humbur. Duhet ta zëmë kohën që na ka humbur.

Qeveria jonë ta nisë punën menjëherë për të garantuar të ardhme të ndritshme republikës dhe për ta jetësuar amanetin e presidentit Rugova për krijimin e një shteti të fortë, demokratik, në miqësi të përjetshme me ShBA-në dhe BE-në", ka deklaruar Osmani. Kurse nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka thënë se opozentët e Osmanit të kapluan nga paniku i humbjes po përdorin metoda për ta dekurajuar votuesin. "Një lajm i rrejshëm është gjoja se presidenti amerikan Trump po e dërgon në Prishtinë dikë. Kjo është rrenë e

kulluar", ka deklaruar Haziri. LDK-ja ka vazhduar fushatën zgjedhore edhe në Pejë dhe në Prishtinë.

"Nisma do të jetë afër atyre njerëzve që kanë nevojë për mbështetje të shtetit. Ne do të vazhdojmë të jemi në mbështetje të punëtorit, të rinjve, të pensionistëve, të arsimit dhe të gruas. Ne duam të kemi deputetë cilësi në Kuvend do të flasë për problemet e qytetarëve të Kosovës. Ne duam të kemi ministra që ua zgjidhin problemet qytetarëve", ka thënë Limaj.

Ai është zotuar para bashkëvendësve të vet se ashtu siç i ka rregulluar rrugët e Kosovës, do ta rregullojë edhe bujqësinë. "Nëse e kemi besimin e qytetarëve të Kosovës nuk do të njihet bujqësia pas katër vjetëve, sepse me punën tonë do ta ndryshojmë krejtësisht atë sikurse i kemi ndryshuar rrugët e Kosovës", ka

thënë Limaj.

Ai ka folur edhe për procesin e dialogut me Serbinë, duke thënë se nuk ka forcë që mund ta detyrojë që të nënshkruajë marrëveshje jo të mirë për Kosovën. Sipas Limajt, Kosova duhet ta përfundojë edhe këtë proces për t'ia hapur vetes perspektivën e zhvillimit dhe të integritimit evropian. Ndërsa kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës, Jakup Krasniqi, ka thënë se më 6 tetor qytetarët e Malishevës duhet ta mbështesin Fatmir Limajn për kryeministër. "Më 6 tetor është dita kur sovranit duhet ta votojë kandidatin e koalicionit bashkë për shtetin, sepse janë njerëzit që dinë dhe duan t'i mbrojnë interesat e kombit. Më 6 tetor është dita kur sovranit duhet ta mbështesë Fatmir Limajn për kryeministër të ardhshëm të Kosovës. Sa më e madhe të jetë përkrahja për Limajn aq më e fuqishme do të jetë Kosova përballë sfidave që e presin pas 6 tetorit", ka thënë Krasniqi.

## Kurti: Erdhi dita e shtetit të së drejtës

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Kandidati për kryeministër i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se mungesa e ilaçeve esenciale dhe mungesa e kujdesit të duhur shëndetësor kanë bërë që qytetarët të vdesin nëpër spitale edhe me sëmundje të shërueshme.

Gjatë një tubimi elektorale në Kamenicë ai ka premtuar se do t'i rritë investimet në shëndetësi për 120 milionë euro. "Erdhi dita që t'i rrisim investimet në shëndetësi

për 120 milionë euro dhe ta rregullojmë sistemin shëndetësor qysh në mandatin e parë katërvjeçar të qeverisë sonë. Dardana ka mbi familje dhe anëtarë të varfër nga skema sociale e cila ua ndan vetëm nga 80 cent në ditë. Me neve në qeveri nuk do të ketë fëmijë dhe të moshuar të varfër, e as qytetarë të varfër në Republikën e Kosovës", ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se erdhi dita e një shteti të së drejtës që e lufton



krimin dhe krimin e organizuar, ku pushtetarët e qytetarit janë njësoj përfundim ligjit e para tij. "I pari i fitores sonë të madhe përforcoi

faktin se me oligarkë e mujsharë nuk ka as drejtësi, as barazi e as zhvillim dhe shtoi se me qeverinë e Vetëvendosjes e kthejmë prodhimin në ekonomi dhe e kthejmë ekonominë në politikë e nuk e lëmë të përjashtuar në tregun ku dominojnë mujsharët e oligarkët", ka deklaruar Kurti.

Kurse kandidati për deputet i kësaj lëvizje, Bajram Mavriqi, ka bërë thirrje për ta bërë ndryshimin. "Ata duan që ne ta braktisim Kosovën dhe Dardanën,

mirëpo ne u përgjigjemi atyre: shpirti nuk shitet dhe atdheu nuk braktiset" ka deklaruar Mavriqi. Ndërsa kandidatja tjetër nga Dardana, Arta Barajlia, ka folur për të drejtat e grave. "Asnjë shoqëri në botë nuk është zhvilluar pa angazhimin e gruas në politikë dhe kjo është e vetmja rrugë për barazi", ka deklaruar ajo.

Lëvizja Vetëvendosje ka mbajtur tubim zgjedhor edhe në Kastriot dhe Gjakovë.

## Limaj: Shantazhuesit në shtëpi, është koha e njerëzve meritore

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Kandidati për kryeministër nga radhët e koalicionit Nisma-AKR-PD, Fatmir Limaj, ka mbajtur të martën tubim elektorale me qytetarët e Drenasit. Ai u ka premtuar qytetarëve të kësaj komune që këtë herë nuk do të ketë shantazh të qytetarëve me vota sepse do të fitojnë të drejtë dhe vullneti i qytetarëve.

"Strukturat tona në Drenas janë kthyer në promotore të ndryshimeve. Deri para pesë vjetëve këtu ka qenë vështirë të flitet për demokraci. Fatkeqësisht, këtu ende ka njerëz që mendojnë se Drenasi është pronë e tyre private. Ky popull ka bërë sakrificat të mëdha, ka pasur dhimbje të mëdha, asnjëherë s'ka lejuar të

preket krenaria e tij. Tani janë çuar disa grupe që po tentojnë ta zhveshin krenarinë dhe të tentojnë që qytetarët t'i qesin në pazar. Unë e kam një porosi për këta njerëz dhe u them shkoni lirshëm në shtëpi, lëri njerëzit të jetojnë lirshëm", ka deklaruar Limaj, duke kërkuar nga qytetarët që më 6 tetor ta votojnë koalicionin Nisma-AKR-PD.

Ndërsa kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka thënë se gjendja e krijuar në vend, ku blihen votat dhe mashtrohen njerëzit, është për keqardhje. "Kosovës i duhet një klasë politike që krijon perspektivën për gjithë kombin dhe gjeneratën e re. Drenasit dhe Kosovës i

duhet udhëheqësi që ndërton shtetin e së drejtës, prandaj Fatmir Limaj është më kompetent për qeverisjen e ardhshme", ka deklaruar Krasniqi. Nisma ka vazhduar fushatën zgjedhore edhe në Lipjan dhe Fushë-Kosovë, kurse Aleanca Kosova e Re (AKR) në Vushtrri dhe Mitrovicë.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka vazhduar të martën fushatën elektorale në qytetin e Gjilanit

# Njeriu i Trumpit: Votojeni Veselin, se forcon miqësinë me Amerikën!

Ish-kreu i Drejtësisë së Administratës Trump, Matthew Whitaker, ka elektrizuar atmosferën në tubimin zgjedhor të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në qytetin e Gjilanit, pasi i ka dhënë mbështetje të martën kandidatit të PDK-së, Kadri Veseli, për kryeministër për zgjedhjet e 6 tetorit. Whitaker ka thënë se Veseli është kandidati për kryeministër që forcon miqësinë me Amerikën, kurse të tjerët e rrezikojnë këtë miqësi. Lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka falënderuar mysafirin, duke thënë se raporti në mes të Kosovës dhe Amerikës është më shumë sesa një lidhje mes dy shteteve të zakonshme



**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Matt Whitaker, ish-kreu i Drejtësisë së Administratës Trump, u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që më 6 tetor ta votojnë për kryeministër kandidatin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli. Në tubimin zgjedhor të PDK-së në qytetin e Gjilanit, ai ka thënë se ShBA-ja i mbështet njerëzit që luftojnë korrupsionin dhe e forcojnë miqësinë me aleatët. Whitakeri u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që të votojnë në këto zgjedhje për Veselin dhe një parti që e forcon raportin me Amerikën dhe jo dikush që e izolon dhe rrezikon

marrëdhëniet. "Pra, më duket se zgjedhja për popullin e Kosovës është mjaft e qartë dhe ju keni një vendim shumë të rëndësishëm për të marrë. Në këto votime zgjedhja është midis: një qeverie që do ta forcojë bashkëpunimin me ne - Shtetet e Bashkuara - për ta luftuar korrupsionin dhe për ta zhvilluar ekonominë tuaj në mënyrë që të krijohet mirëqenie dhe sukses për të gjithë. Mundësitë tuaja alternative përbëjnë një rrezik, bëhet fjalë për një qeveri të udhëhequr nga politikanë që mund ta izolojnë Kosovën dhe do t'i dëmtojnë marrëdhëniet tuaja me ne. Për një qeveri që nuk mund ta luftojë korrupsionin", ka thënë Whitaker.

Më tej, ai ka shtuar se parakusht për ardhjen e investitorëve amerikanë në Kosovë është luftimi i korrupsionit. "Që të vijë këtu bizneset dhe investitorët amerikanë duhet të jenë në gjendje t'u besojnë udhëheqësve dhe qeverive të qeverive të huaja. Parakusht është luftimi i korrupsionit si një kriter i domosdoshëm. Tani për tani amerikanët kanë hezitur të investojnë në Kosovë për shkak të frikës që kanë prej korrupsionit. Kadri Veseli nuk paraqet rrezik në këtë aspekt. Ai është një reformator. Kadri Veseli është mik i Shteteve të Bashkuara dhe mik i Iowas", ka thënë Whitaker.

**Veseli falënderon ish-ministrin e Trumpit: Mbështetja juaj flet shumë**

Ndërkaq kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryeministër, Kadri Veseli, ka falënderuar Whitaker: "Faleminderit, Matt! Mbështetja dhe prania juaj sot këtu me ne është shumë domethënëse. Ashtu siç është frymëzues edhe ky entuziazëm këtu në Gjiçan dhe

në tërë Kosovën për fitoren tonë, fitoren e Partisë Demokratike, fitoren e Kosovës", ka thënë Veseli.

Lideri i PDK-së ka thënë se Amerika ishte gjithmonë në anën tonë, në kohë të vështira të luftës dhe në çaste historike të pavarësisë. "Amerika ishte gjithmonë këtu! Duke ecur krah për krah me ne. Duke na ndihmuar në rrugëtimin tonë. Dhe sot presidenti Donald Trump është një mik i vërtetë i Kosovës. Raporti në mes të Kosovës dhe Amerikës është më shumë sesa një lidhje mes dy shteteve të zakonshme. Është raport mes dy idealeve dhe dy vlerave të jashtëzakonshme. Amerika është një fuqi e bazuar në liri dhe demokraci dhe ne kemi vlera të përbashkëta me të. Për këtë arsye, Amerika do të na mbështesë dhe do të qëndrojë pranë nesh. Dhe ne duhet ta ruajmë këtë miqësi dhe partneritet! Ne nuk duhet të bëjmë asgjë që do ta rrezikonte aleancën më të rëndësishme strategjike në historinë e Kosovës. Prandaj, këto janë zgjedhje kritike për të ardhmen e vendit tonë", ka thënë Veseli.

Më 6 tetor Veseli ka thënë se

qytetarët duhet të zgjedhin midis një qeverie që e udhëheq PDK-ja, e cila do ta forcojë partneritetin me Amerikën dhe Bashkimin Evropian. "Së bashku me ta do ta fitojmë luftën kundër korrupsionit, do ta zhvillojmë ekonominë, do t'i mbajmë të rinjtë këtu dhe të ofrojmë shpresë dhe një të ardhme", ka thënë Veseli.

Ose, për alternativën tjetër, ai ka thënë se është një koalicion i izolimit, korrupsionit dhe përçarjes. "Para nesh qëndron një moment kthese historike. Për t'u dhënë fund dilemave, ndarjeve dhe për t'i dhënë udhë shpresës, bashkimit, të ardhmes. Dhe 6 tetori është shans që nuk guxon të humbet! Me mua kryeministër, Kosova nuk do t'ua mbyllë derën miqve tanë perëndimorë. Por, do të punojë edhe më fuqishëm me ta, për të mirën e Kosovës, për të mirën e partneritetit. Amerika është aleatja jonë më e fortë. Është mbrojtësja dhe mbështetësja më e madhe. Amerika është e shenjtë për ne! Dhe e ardhmja e Kosovës do të jetë më e mirë dhe më e sigurt me një mbështetje të fortë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës", ka thënë Veseli.



## Pacolli në Prizren bën thirrje që të votohet koalicioni Nisma-AKR-PD

**PRIZREN, 1 TETOR (ER)** - Aleanca Kosova e Re para qytetarëve të Prizrenit ka shpalosur programin e vet politik në prag të zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare të 6 tetorit. Presidenti i AKR-së, Behgjet Pacolli, duke folur para qytetarëve të Prizrenit, tha se ai e sheh ardhmërinë në Kosovë përmes punës. "Kosova ka diçka të shenjtë që të tjerët nuk e kanë, ka rininë, rini aktive, inteligjente, e shëndoshë dhe dinamike. Dhjetëvjeçari i ardhshëm është

dhjetëvjeçari i rinisë së Kosovës. Ju do të jeni bartës të proceseve politike në vend", tha Pacolli për të rinjtë e Kosovës. Ai, po ashtu, tha se të rinjtë shumë shpejt do të udhëtojnë pa viza dhe për këtë ai tha që ka marrë përkrahjen edhe sot në takimin që kishte me ministrin e Jashtëm të Finlandës. Shpendi Shuki nga Dega e AKR-së në Prizren para prizrenasve e cilësoi presidentin e AKR-së, Behgjet Pacolli, si njeriu dhe shqiptarin më të suksesshëm në

trevat tona, vizionar dhe humanist, njeri të fjalës, që do t'i prijë ndryshimit që i duhet Kosovës. Në fund u bë edhe prezantimi i kandidatëve për deputet nga radhët e AKR-së. Të pranishëm në këtë tubim elektorale ishin: Behgjet Pacolli, Islam Pacolli, Mirlinda Sopi-Krasniqi, Shqipe Kupina, Refiqe Tërnavë, Vesel Makolli, Fatmir Matoshi, Myzejene Selmani, Ekrem Mustafa, Sevdije Lama, Avdullah Mehmeti, Alma Lamçja dhe Ymer Rogova.



# Pse Hasan Jashari ka vendosur t'i hyjë politikës dhe t'i bashkohet AKR-së

Intelektuali dhe ish-luftëtari i UÇK-së, Hasani Jashari, ka treguar se ka hyrë në politikë me synimin për ta përmirësuar gjendjen e keqe në të cilën ndodhet vendi. Ai ka bërë më dije se ka vendosur t'i bashkohet Aleancës Kosova e Re (AKR) për shkak të programit të mirë të saj i cili mundëson zhvillimin ekonomik të shtetit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Jashari ka thënë se do ta japë kontributin e tij për ta vendosur në binarë sistemin e drejtësisë



**EPOKA E RE** Faton DERMAKU

PRISHTINË, 1 TETOR -

**"Epoka e re":** Z. Hasani, si pjesëtar i lagjes Jashari, si familje e dëshmorit të kombit Smajl Jashari, si luftëtar dhe veteran i UÇK-së, pse keni vendosur të angazhoheni në politikë?

**Hasani:** Duke e parë gjendjen në Kosovë, thuajse në të gjitha poret e jetës qytetarët me të drejtë kanë humbur besimin në këtë klasë politike dhe të udhëheqësit institucional. Po shihet se kemi një sistem të drejtësisë jo të mirë, një shëndetësi jo të mirë, një arsim jocolësor dhe një ekonomi jo të zhvilluar. Qytetarët e Kosovës, duke e parë këtë gjendje, çdo ditë po i humbin shpresat se do të bëhet mirë dhe çdo ditë me lot në sy po e lëshojnë vendin e tyre. Prandaj kam vendosur që si qytetar i Republikës së Kosovës të angazhohem me tërë potencialin tim profesion-

al, moral dhe intelektual së bashku me ata që e duan shtetin e Kosovës, të cilët nuk abuzojnë me këtë shtet, që të punojmë që qytetarëve të Kosovës t'ua kthejmë besimin në institucionet e shtetit të Kosovës, pra t'ua kthejmë shpresat. Kosova ka njerëz që e duan vendin e tyre, por që duhet të mos heshtin dhe mos të rrinë indiferentë ndaj kësaj gjendje. Të ndërtojmë një shtet të së drejtës, një sistem të mirëfilltë të drejtësisë, ku të gjithë qytetarët ndihen të barabartë para ligjit. Së bashku të punojmë për ndërtimin e shtetit të Kosovës që na obligon gjaku i atyre që dhanë jetën për lirinë e vendit, na obligon sakrificat e madhe e popullit tonë, që të punojmë për ndërtimin e shtetit dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

**"Epoka e re":** Pse zgjodhët AKR-në?

**Hasani:** I kam analizuar të gjitha programet e partive politike. Duke u bazuar se AKR-ja është në koalicion me Nismën Socialdemokrate dhe Partinë e Drejtësisë, ka programin më të mirë për ndërtimin e shtetit dhe zhvillimin ekonomik si dhe AKR-ja ka një lider politik i cili me argumente ka dëshmuar se e do shtetin dhe punon me duar të pastra. Një lider i cili nuk është pjesë e krimit dhe korrupsionit dhe as bashkëpunëtorët e tij ka qenë arsyeja pse kam vendosur të rreshtohem në AKR. Pjesë e AKR-së nuk jam vetëm unë, por jemi një familje e gjerë dhe një pjesë e lagjes Jashari. Z. Pacolli në vendin tonë njihet si personalitet me vlera të larta njerëzore, morale, kombëtare, intelektuale dhe njihet si njeri i madh human, si biznesmen dhe është një burrështetas

me përmasa botërore. Kosova ka nevojë për njerëz siç është z. Behgjet Pacolli.

**"Epoka e re":** A keni kërkuar ndonjë kusht për t'u bërë pjesë e AKR-së?

**Hasani:** Kushtin e vetëm që kam kërkuar e kam gjetur pikërisht në këtë subjekt politik. Aty ku do të rreshtohem lideri të jetë një person që e do vendin dhe që punon për shtetin e Kosovës dhe i cili punon për zhvillimin ekonomik të vendit, pra ky ka qenë kushti që kam kërkuar për t'u bërë pjesë e AKR-së. Këtë e kam gjetur në AKR. Qëllimi im është që të punojmë me të gjitha forcat që shtyllën e parë të shtetit, që është sistemi i drejtësisë, ta vëmë në binarë, ta bëjmë një vet-ing, një filtrim për gjyqtarët dhe prokurorët për faktin se sistemi i drejtësisë është çelësi kryesor për

të gjitha hallkat e tjera të shtetit.

**"Epoka e re":** Nga lagjia juaj është edhe kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari. Sa mendoni se qytetarët e kësaj komune janë të kënaqur me qeverisjen e tij?

**Hasani:** Bekim Jashari është djali i heroit kombëtar Hamëz Jashari dhe është kryetar komune. Si kryetar komune i pavarur që nga dita e parë e punës së tij shihen rezultatet e suksesshme. Unë dhe të gjithë qytetarët e Skenderajt ndihemi krenarë me punën që është duke e bërë z. Bekim Jashari. Ne do ta mbështesim në çdo aspekt, kudo qoftë, programin e tij në të mirë të Komunës së Skenderajt. Kam respekt për kryetarin e Komunës së Skenderajt, z. Bekim Jashari. Mbështetja për të nuk do të mungojë.

## Koç Hospital nga Turqia do t'i aftësojë mjekët nga Kosova

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Një delegacion i udhëhequr nga dr. Basri Sejdiu, drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, ka qëndruar për vizitë pune në Koç University Hospital në Turqi. Qëllimi i vizitës ishte mundësia e trajnimit të mjekëve dhe stafit tjetër shëndetësor për përdorim të metodave të avancuara diagnostike dhe kirurgjike (minimale invazive). Në takimet që ka pasur

me drejtuesit e këtij institucioni, drejtori Sejdiu ka kërkuar përkrahje për trajnime të stafit. Sipas drejtorit Sejdiu, pas diskutimeve konstruktive që kanë pasur ky institucion ka mundësuar trajnime falas për 20 deri në 30 mjekë, sidomos në fushat që janë deficitare në QKUK. Dr. Ozgur Deniz Tezcan nga Koç Hospital University ka thënë se nga takimi që kanë pasur me drejtorin e ShSKUK atyre u është

kërkuar ta mundësojnë trajnimin e mjekëve nga Kosova. "Ne jemi të gatshëm t'i presim mjekët në trajnime në 3 grupe, me nga 20 deri në 30 mjekë që do t'i mësojnë metodat më të avancuara në mjekësi dhe përdorimin e aparaturave të fundit mjekësore", ka thënë dr. Tezcan. ShSKUK-ja pritet që së shpejti ta dorëzojë listën e mjekëve që do të shkojnë për trajnim në Koç University Hospital në Turqi.





## Limaj: Pensionistët e Kosovës do t'i trajtojmë dinjitetshëm

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Kandidati për kryeministër nga koalicioni Nisma-AKR-PD, Fatmir Limaj, në Ditën Ndërkombëtare të të Moshuarve, ka theksuar rëndësinë e avancimit të mirëqenies së përgjithshme të kategorisë së moshës së tretë. Ai ka thënë se në Kosovë të moshuarit nuk kanë gëzuar sa duhet përkrahje nga shteti deri në kohën kur Nisma Socialdemokrate ka marrë përgjegjësitë e saj në qeverisjen aktuale. "Nën drejtimin e

Ministrit së Punës dhe Mirëqenies Sociale nga ministri Skender Reçica, pensionistët në Kosovë më në fund kanë nisur ta ndiejnë dorën e përkujdesjes nga shteti. Një nga objektivat kryesore të Nismës është paketa sociale e cila parasheh reformën pensionale, me theks të veçantë sigurimet sociale. Po aq i rëndësishëm është edhe realizimi i zotimit tonë për sigurimin shëndetësor, që me jetësimin e tij do të ketë lehtësira të shumta për të moshuarit tanë. Me reformën rënjësore në fushën e pension-

eve, të cilën e kemi filluar vitin e kaluar, pensionistët e të gjitha kategorive do të trajtohen dinjitetshëm", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook". Limaj ka thënë se në qeverinë e ardhshme do të punojnë për finalizimin e reformës pensionale. "Ne do të angazhohemi fuqishëm që në qeverinë e ardhshme ta finalizojmë reformën e nisur, me qëllim që të gjitha kategoritë e të moshuarve në Kosovë të gëzojnë trajtim të duhur dhe mirëqenie më të mirë", ka shkruar Limaj.



# Në vitet e ardhshme do të ketë numër më të madh të të moshuarve



Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Personave të Moshuar, me moton "Rrugëtimi drejt barazisë moshore", drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik në Kosovë, Naser Ramadani, ka thënë se trendi i moshimit është në ngritje në Kosovë

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 1 TETOR - Rreth 6.7 për qind e popullatës në Kosovë janë persona të moshuar dhe të njëjtit përballen me kushte jo të mira jetese e qasje të kufizuar në shërbimet shëndetësore. Kështu është thënë të martën në shën-

imin e Ditës Ndërkombëtare të Personave të Moshuar, me moton "Rrugëtimi drejt barazisë moshore".

Drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik në Kosovë, Naser Ramadani, ka thënë se në mënyrë tradicionale po shënohet kjo ditë me qëllim të mbështetjes dhe përmirësimit të gjendjes së

popullatës së moshuar në Kosovë. Sipas tij, objektivat e kësaj dite janë që të ndihmojnë, ta ngrehin vetëdijesimin dhe parandalimin e pabarazisë, të shqyrtohen mundësitë për mësimin gjatë gjithë jetës dhe të reflektohet në praktikën më të mira për t'u dhënë fund stereotipave. "Trendi i moshimit është

në ngritje në Kosovë. Janë 6.7 për qind të moshimit në Kosovë. Ndryshime të tilla tregojnë se në vitet do të ketë numër të madh të të moshuarve", ka thënë Ramadani.

Ndërsa Faik Hoti nga Ministria e Shëndetësisë ka thënë se moshimi nuk nënkupton sëmundjen apo paaftësinë. "Të moshuarit në Kosovë përballen me kushte jo të mira jetese, me pensione të ulëta, edhe qasja në shërbime shëndetësore është e kufizuar", u shpreh Hoti.

Në anën tjetër, shefi i

Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) në Kosovë, Sergy Koryak, ka thënë se numri i të moshuarve në botë është në rritje. "Janë mbi 700 milionë persona në mbi 60 vjet e në 10 vjetët e ardhshëm pritet të jetë mbi 1 miliard e gjysmë. OBSh-ja çështjen e të moshuarve e sheh si e drejtë humane dhe themelore për të moshuarit", ka thënë ai.

Kurse Hasan Berisha nga Lidhja e Pensionistëve ka thënë se të moshuarit në Kosovë kanë pensione të ulëta pavarësisht prej kontributit paraprak.

## Sot një pjesë e Fushë-Kosovës do të ketë ndërprerje të ujit të pijshëm

Prishtinë, 1 tetor (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjetësimit "Prishtina" me anë të njoftimit për media ka bërë me dije se pjesa që furnizohet me ujë nga gypi i ri, Fabrika e Trajtimit të Ujit

Shkabaj deri në Fushë-Kosovë, gjatë ditës së sotme (e mërkurë), duke filluar nga ora 09:00 deri në orën 12:00, do të ketë ndërprerje të furnizimit me ujë të pijshëm. Arsyja e ndërprerjes së

furnizimit me ujë është kyçja e 150 konsumatorëve të fshatit Nakaradë në gypin e ri të furnizimit me ujë të pijshëm. Sipas KRU "Prishtina", këta 150 konsumatorë deri më tash janë

furnizuar me ujë të pijshëm nga objekti prodhues Kroni/Kuzmin në Fushë-Kosovë, ndërsa nga e mërkura do të furnizohen me ujë nga Fabrika e Trajtimit të Ujit në Shkabaj.



## QKMF-ja e Malishevës bëhet edhe me dy autoambulanca të reja

**MALISHEVË, 1 TETOR (ER)** - Në kuadër të investimeve të Komunës së Malishevës në sektorin e shëndetësisë, me qëllim të ofrimit të kujdesit më të mirë shëndetësor, në veçanti të ofrimit të shërbimit të shpejtë, urgjenca e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr. Shpëtim Robaj" në Malishevë është pajisur edhe me dy autoambulanca.

Pas kryerjes së procedurave të blerjes së autoambulancave, të martën edhe zyrtarisht kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dhe drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, Liridon Hoti, ia kanë dorëzuar veturat e ndihmës së shpejtë drejtorit të QKMF-së në Malishevë, Nuhi Morina. "Ne jemi duke e bërë të pamundurën

që në të gjithë sektorët të investojmë në mjete, e sidomos në fushën e shëndetësisë, që gjithmonë do të jetë prioritet për ne, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të mira dhe më të shpejta shëndetësore", ka thënë Begaj, duke shtuar se këto autoambulanca do të ndihmojnë në kryerjen e shërbimeve në raport me pacientët. Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Liridon Hoti, ka treguar se këto dy autoambulanca i kanë kushtuar buxhetit komunal rreth 62 mijë euro, ndërsa drejtori i QKMF-së në Malishevë, Nuhi Morina, ka treguar se tani i kanë pesë autoambulanca të cilat janë të mjaftueshme për nevojat e shërbimit të urgjencës.



## Në Drenas mbahet debati publik për raportin e vlerësimit strategjik mjedisor



**DRENAS, 1 TETOR (ER)** - Komuna e Drenasit ka arritur ta përfundojë me sukses Raportin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) dhe Planin Zhvillimor të Komunës. Për të prezantuar dhe diskutuar për këtë raport, të martën është mbajtur debat publik në sallën e Kuvendit Komunal. Hapjen e këtij debati publik e ka bërë Drejtoresha për Planifikim

Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Flutura Avdiu. Me këtë rast, ajo ka falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje, derisa ka ftuar pjesëmarrësit të japin komente dhe sugjerime lidhur me plotësimin e raportit të VSM-së në mënyrë që të jetë sa më i plotë dhe profesional. Në hartimin e raportit të VSM-së kanë kontribuar shoqëria civile, profesionistët

dhe ekspertët e fushave relevante, të cilët edhe sot morën pjesë në përfundimin e procedurave për aprovimin e këtij raporti. Ndryshe, qytetarët e Komunës së Drenasit nga data 10 shtator kanë pasur hapësirë për të dërguar komente dhe sugjerime në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit lidhur me këtë raport.



## Vitia shënon Ditën Botërore të të Moshuarve

**VITI, 1 TETOR (ER)** - Komuna e Vitit të martën ka shënuar Ditën Botërore të të Moshuarve. Në kuadër të kësaj dite është vizituar ambientin ku bëjnë qëndrim ditor të moshuarit vitias dhe me këtë rast iu është bërë matja e tensionit arterial, glikemia, si dhe u janë dhënë këshilla si të mbrohen nga ushqimi e të merren me aktivitete

fizike etj. Po ashtu, është bërë edhe shpërndarja e fletushkave me këshilla për sëmundje kronike. Sipas dr. Vjollca Kadolli-Halili, drejtoreshë e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Viti, aktivitetet e tilla janë duke u shënuar me qëllim të sensibilizimit të qytetarëve për sëmundje të ndryshme.



## Ahmeti: Parku në lagjen 'Arbëria', me pamje mbresëlënëse nga Prishtina

**PRISHTINË, 1 TETOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se lokacioni ku është ndërtuar parku në lagjen "Arbëria" është transformuar dhe revitalizuar nga një deponi në një hapësirë të organizuar që do t'i shërbejë të gjithë komunitetit. Ai ka thënë se ky park në lagjen "Arbëria" ka të

gjitha elementet e një parku modern. "Në një sipërfaqe prej 2.5 hektarësh ky park e ka fushën e futbollit, basketbollit, këndin e lojërave, shtigjet për vrapim dhe këmbësorë, sipërfaqe gjelbëruese dhe një pamje mbresëlënëse nga Prishtina", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

# Nderohet vepra e ish-rektorit Ejup Statovci



Në 22-vjetorin e protestave të studentëve, rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", prof. dr. Marjan Dema, ka bërë homazhe të martën tek ish-rektorati në Velani, në nderim të ish-rektorit Ejup Statovci. Ndërsa e bija e ish-rektorit Ejup Statovci, Anila Statovci, në emër të familjes e falënderoi rektorin Dema për përkujtimin e veprës së babait të saj

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 TETOR - Me rastin e 22-vjetorit të protestave të studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", rektori prof. dr. Marjan Dema ka bërë homazhe të martën tek ish-rektorati në Velani, në nderim të ish-rektorit Ejup Statovci. Duke e konsideruar ish-rektorin Statovci

si një rektor historik, i pari i universitetit e quajti 1 tetorin ditë të veçantë. "Sot në Universitetin e Prishtinës fillon viti i ri akademik dhe arsyeja tjetër se pse kjo ditë është e veçantë është kjo që para 22 vjetësh, pikërisht nga ky vend, nën udhëheqjen e rektorit historik Ejup Statovci, studentët e UP-së ia mësynë ndryshimit pozitiv, i cili edhe më vonë ndodhi", ka thënë rektori Dema.

## Liderët e Lëvizjes Studentore nderojnë ish-rektorin Ejup Statovci

Liderët e Lëvizjes Studentore, të cilët kishin organizuar protestën e 1 tetorit të vitit 1997, Bujar Dugolli, Albin Kurti, Muhamet Mavraj dhe

Driton Lajçi, kanë bërë homazhe të martën te varri i ish-rektorit të UP-së, Ejup Statovci. Kryetari i kësaj lëvizje, Bujar Dugolli, ka

thënë se Ejup Statovci ka qenë mbështetësi i palëkundur i studentëve në protestën e mbajtur para 22 vjetëve.



Ndërsa e bija e ish-rektorit Ejup Statovci, Anila Statovci, në emër të familjes e falënderoi rektorin Dema për përkujtimin e veprës së babait të tyre. "Rinia e një

vendi është forca lëvizëse e saj. Andaj, jam krenare që babi im ishte një ndër ata që inicioi transformimin pozitiv për Kosovën", ka thënë ajo.

Prof. dr. Ejup Statovci ishte profesor në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Juridik dhe rektor i Universitetit të Prishtinës prej vitit 1991 deri më 1997.

# Fillon viti i ri akademik 2019-2020, Fakulteti i Edukimit pajiset me 30 kompjuterë të rinj

EPOKA E RE

Q. RAMA

PRISHTINË, 1 TETOR - Me rastin e fillimit të vitit të ri akademik 2019-20, Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" u pajis me 30 kompjuterë të rinj, të dedikuar për nevojat e studentëve të këtij fakulteti. Pajisja e kësaj salle me këta kompjuterë ishte donacion nga kompania "Al Trade Center", me qëllim të ndihmesës së studentëve të rinj të këtij fakulteti gjatë studimeve të tyre.

Shumë të nevojshëm e quajti këtë donacion rektori i UP-së, prof. dr. Marjan Dema, i cili nuk kurseu falënderimet për donatorin. "Një ndër pikat kryesore të cilën ne si menaxhment e kemi vendosur si

objektiv në planin strategjik të UP-së është zhvillimi i sistemit në funksion të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies, hulumtimeve dhe shërbimeve. Ky objektiv është i pasuruar me hapa të qartë për arritje të këtyre synimeve dhe inaugurimi sot i kësaj salle të pajisur me kompjuterë shënon një hap të tillë në këtë drejtim", ka thënë rektori Dema.



## Rektori Temaj uron studentët për fillimin e vitit të ri akademik

Në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren të martën ka nisur viti akademik 2019/2020. Të gjitha njësitë akademike i kanë bërë përgatitjet e nevojshme për fillim të semestrit të parë të këtij viti akademik.

Rektori i UPZ-së, prof. asoc. dr. Ismet

Temaj, me këtë rast të gjithë studentëve, stafit akademik dhe administrativ u uroi fillim të mbarë të vitit akademik, duke u dëshiruar suksese.

Procesi mësimor do të zhvillohet normalisht në vitin e dytë, të tretë dhe në vitin e katërt në drejtimet përkatëse, po ashtu

edhe në nivelin master. "UPZ-ja është duke punuar për tejkalimin e sfidave. Falë punës dhe përkushtimit të menaxhmentit dhe gjithë stafit është shënuar përparim dhe bashkërisht besojmë se do t'i tejkalojmë. Urime dhe suksese në vitin akademik 2019/2020!", ka thënë Temaj.

## Haradinaj viziton Mensën e Studentëve

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - "Breza e breza të studentëve kanë sakrifikuar për liri e disa kanë rënë në frontet e luftës për nxënie të dijes, por edhe vlerave tona si vend", kështu ka thënë kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë vizitës që i bëri të martën Qendrës së Studentëve në Prishtinë me rastin e fillimit të vitit të ri akademik.

Kryeministri në detyrë, Haradinaj, i shoqëruar nga drejtori i kësaj qendre, Fatmir Sfishta

dhe ministri në detyrë i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka vizituar konviktin nr. 7 dhe atë nr. 8, ku ka parë nga afër kushtet dhe ambientet në të cilat banojnë studentët. Po ashtu, kryeministri në detyrë, Haradinaj, vizitoi edhe Mensën e Studentëve, me ç'rast ka drekuar së bashku me studentët e qendrës. Me këtë rast, kryeministri në detyrë, Haradinaj, tha se është me rëndësi që të shihet në praktikë gjendja në konvikte, ku nga

drejtori Sfishta është njoftuar se janë 4 000 studentë të akomoduar në konvikte dhe 2 500 të tjerë që kanë të drejtë në shujtë. "Qeveria që kam udhëhequr ka punuar që të jetë afër të rinjve, studentëve, afër arsimit të lartë, të mesëm dhe të ulët dhe do të vazhdojmë edhe në të ardhmen", ka thënë Haradinaj, duke uruar studentët për një vit të mbarë dhe duke shprehur respekt për kontributin e rinisë studentore në të gjitha etapat.



# Entrofia e fushatës zgjedhore, insufienca e një politike me premtime boshe



Prof. dr. Hakif BAJRAMI

Zgjedhjet po afrohen. Sytë hapi këtë herë, ik prej fajdexhinjve e mos shko me rentierë. Tani zgjedhës janë afër dy milionë. Partitë "demokratike" i lutën Zotit që në zgjedhje të dalin vetëm 30 deri në 42 për qind. E kjo votë është anëtarësia e tyre. Zgjedhës, kam doktoruar më 1979 në sistem shumë-partiak. Nëse dilni në zgjedhje, 80 deri në 95 për qind, do të kishim vërtetë demokraci dhe drejtësi pas rezultateve zyrtare. Me këtë votë 80-95 për qind padrejtësitë nuk do të pushojnë plotësisht, por do të shpërputet fuqia e korrupsionit, pasigurisë investive, nepotizmit, keqpërdorimeve dhe hajnive "demokratike", në stilin depspotik apo komunist.

Me daljen e 95 për qind të votuesve do të kemi kualitet më të mirë dhe hajni shumë më pak dhe gradualisht padrejtësitë do të pushojnë. Shikojeni Gjermaninë pas 1975-s. Tani situata është e "pastër" si loti, se kush do të na përfaqësojë, kush do ta "luftojë" korrupsionin, nepotizmin, hajdutërinë publike dhe drejtimin e shtetit dhe fuqishëm po na sigurojnë?

Listave të partive me ngjyra mëhallësh u prinë: Albin Kurti (LV), Vjosa Osmani (LDK), Ramush Haradinaj (AAK-PSD), Kadri Veseli (PDK), Fatmir Limaj (Nisma-AKR). Të gjithë vërehet se në tru e kanë të vizatuar formulën I+I (ideal+iluzion). Asnjëri nuk e di se cili është partneri ynë ekonomik. Atëherë me cilin shkop do të na shpijnë përpara. Jo, varfërinë dhe izolimin e kemi të sigurt. Lidhur me këtë, asnjëri prej tyre nuk është pa përvojë në politikë. Por shikojeni se si disa snajperistë të tyre hedhin urrejtje. Asnjëri deri tash (përfashtim bën Albin Kurti!) nuk i ka ofruar popullit formulë programore ekonomike prej kah do të nxirret Kosova nga "këneta e vdekjes", e po këta e kanë vënë thellë e më thellë në pasiguri. E pse po shprehem kaq egër. Po provoi të përgjigjem, jo për inate, por pse po më dhemb kurrizi nga pesha e padrejtësive, që e ka sjellë pikërisht faktori politik idealist sot në Kosovë, me jotrashpencë (insufiencë rrenash), me atrofi rrenash para popullit, duke e vënë peshën e vendimeve të të huaj, me papërgjegjësi totale profesionale, diplomatike dhe politike, me pasiguri investuese

ekonomike. Asnjëri prej pretendentëve të marrjes së pushtetit, nuk e ka programin se si do të sillen me ata që na i "prenë jelekët", me ata që provojnë të na lënë lakuriq, pa pavarësi e të na kthejnë në harkun e Serbisë koloniale por që, fatlumësisht, "as ata - serbët, as ne - shqiptarët", sikur nuk kemi gjë në dorë, sepse po thuhet: në këtë muaj do të kemi pajtim, për çka, e ai askund. Këtu jemi edhe sot. Asnjëri nuk e ka të shkruar: 'do ta dëgjojmë ShBA-në', mikun më të sinqertë të çështjes shqiptare; do ta kuptojmë BE-në që partnerë të tregut të sigurt për Kosovën nuk ka; do ta hetojmë se çka duan Rusia dhe Kina me Indi e Iran e Brazil sot e njëzetë vejtët që vijnë, të cilat i kanë brenda shumë "Kosova" të robëruara. Prandaj, me të gjitha mjetet që i kanë me përjashtim të bombave atomike, ende e luftojnë UÇK-në, Republikën e Kosovës, sepse i frikësohen modelit të tillë të luftës së drejtë, për pavarësinë e popujve të robëruar apo të shtypur, në oborret e tyre.

Ku jeni politikanë shqiptarë, dini ju diçka nga politika serbo-ruse dhe evropiane për shfarosjen e shqiptarëve për dy shekuj me radhë (XIX dhe XX). Po, ju i keni "valixhet ekonomike" për tender, por jo për partnerë. E politika serbe i ka 33 programe që nuk kanë skadencë as në fillim të XXI. E vërteta nuk mund askush ta mbulojë "kasollen" e vet pa e ditur se çka ka në "pallatin" urretës të armikut. Në fakt, sot në Evropë 94 popuj aspirojnë liri dhe pavarësi, me të drejtë, në pozitë si ishte Kosova. Kanë kaçik këta politikanë të Kosovës t'u dalin në ballë makinerive që blujnë çdo gjë që u del përpara, të paktën në Evropë sot, sepse për Afrikë mos të flasim, sepse atje e ke mik atë që ka ma shumë para, për t'i plasuar në xhepat e hapur në çdo kohë. Kush jep ma shumë, atë e pranojnë sot, nesër e "ç'pranojnë". Nëse paguan sërish, prapë të pranojnë!

Kur jemi te një realitet i tillë, që pushtetarët tanë nuk u bëjnë debat publik, po jua shtroi këto pyetje: Pse nuk u botua i plotë shqip, Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Kosovën më 2010? Pse së pari e botoi ministri i LDK-së anglisht?! Së dyti e botoi ministri i AKR-së, prapë vetëm në gjuhën angleze. Së treti, pse nuk bëhet publike sjellja e Ramush Haradinajt ndaj Frederika Mogerinit në takimin e parë kur Ramushi në stilin e vet prej trimi ia përplasi letrat në fytyrë për tregti me territore të Kosovës. Së katërti, pse nuk bëhet publik rasti më i freskët, kur min-

istri i Punëve të Jashtme i Spanjës e lëshoi mbledhjen porsa e pa Behgjet Pacollin në mbledhje të vendeve ballkanike, e spanjollit nesër (ama nesër) do të jetë sekretar i Punëve të Jashtme të BE-së? Çka pritet prej tij, përpos më keq se tregtia e imponuar nga A. Sorrosi, Vuçiçi e Thaçi, Bolltoni, Rama, plus Frederika e Italisë. E kush do t'ia përplasë letrat prej gjashtë kryeministrave të plasuar tash për zgjedhjet e 6 tetorit 2019, e që si "luaj" japin premtime boshe. Me fjalë do të trembet nesër spanjollit? A do të dalë një apo dy, që do të kanë guxim të na "prishë me ndërkombëtarët", siç thoshte Ibrahim Rugova, Isamil Kadare e ndonjë mace ndër sofër, për Adem Demaçin, kur ishte në pyetje veridikt i panegociueshëm në Rambuje më 1999, për të cilin po paguajmë haraç edhe sot, e nuk e dinin se bombardimi i Jugosllavisë Zhablakut ishte i përgatitur në maj të vitit 1998, i provuar në gusht dhe dihehin caqet e bombardimeve në shtator të 1998-s. Lexoni injorantë dokumentet e CIA-s, të botuara si dokumente publike tash. E rezultatin e ka pasur të njohur Adem Demaçi, mu atëherë (qershor 1998). Kush ju furnizon juve sot me informata, ambasadorët ilake dhe të pashkollë. Historinë do ta përsëritni me këto insufienca premtimesh boshe edhe pas 6 tetorit 2019. Thoni çka të doni, por ju e keni shkatërruar tokën bujqësore në Kosovë, ju e keni degraduar urbanizmin në çdo qytet, ju i keni tjetërsuar fabrikat, uzinat dhe pronat e kooperativave nën firmën "prona shoqërore në ferr, prona private në parajsë". E të dyja i keni dërguar në purgator, pa partner ekonomik. Ju e keni shkatërruar PTK-në, ju jeni ata që e keni degraduar arsimin me ministra që kanë studiuar nga 12 vjet, ju e keni shkatërruar shëndetin me ambulante private. Ju nuk jeni ata që do të duhet ta informoni popullin, a më shumë kanë investuar të huajt në Kosovë nga 10 qershor 1999 apo kanë grabitur prej saj, sepse me ta keni bashkëvepruar. Ju jeni ata që keni bërë ligj për veteranët e sot akuzoni disa persona që janë heroj të luftës. Jo, një herë duhet ligji t'i kategorizojë veprimet në luftë. E atë mund ta bëjnë vetëm ata që e dinë çka është lufta e jo profiterët dhe kllosharët e kioskave. Pse nuk e zbuloni se çka nënshkruan tre historianë për UÇK-në, me kërkesë të UNMIK-ut. Po tregoi se nënshkruan se në Kosovë nuk ka pasur luftë, por ishte një konflikt. E luftë në filozofinë e historisë do të thotë ndryshim i kufi-

jve. Ndërsa konflikt, në filozofinë e historisë do të thotë ndryshim i regjimit (në rastin konkret në Beograd). E ata që nënshkruan "Konflikt", sot janë "emra" nga Akademia e plagjiatorëve e deri te parlamenti aspirues. Sot njëri ndër juristët që 23 herë lejoi të shkelet Kushtetuta e Kosovës është akademik e tjetri është prof. ordinar. Për këtë "dituri moderne" dëshmon Marrëveshja e Brukselit në mes të Republikës së Kosovës (hulumtoni a shkruan Republikë?) dhe Serbisë, më 2013 dhe 2015. Unë nuk ju urej, por jeni injorantë në veprime. Deri ku pati ra poshtë sovraniteti i Kosovës në Vjenë (?) me politikanë të verdhë, me nga një fakultet me korrespondencë. Arrijmë te Edita Tahiri me fakultet teknik, e doktoratë allafranga si shumë të tjerë, që i filloi bisedimet "teknike", e ato triumfalisht i konvertoi në puro politike, sepse ua kurdisi fusnotën të gjitha të arriturave. Politikanë të mëhallëve vetëm kujton rastin e pranimit të Arkivit të Kosovës në gjirin e arkivave shtetërore të shteteve të botës në kategorinë "A", me sukses të plotë. E ju për këtë do të thoni se problem i vogël është ky. Po ta dini se arkivi është shteti, si himni, si flamuri dhe stema, madje diçka më tepër. Po aty serbianët e patën lëshuar mbledhjen dhe kah dalin për dere u ishte thënë: "Ruenu se keni marrë turr e po mbyteni në det, se aty e keni vendin. Ka kaluar koha e faraonëve komunistë dhe të 411 delegatët kanë duar-trokitur". E merrni pranimin e Futbollit të Kosovës në FIFA dhe UEFA me meritë të një atdhetari dhe të dituri, në atë lëmë, që e ka shansin sot, sporti jonë të jetë anëtar në industrinë e dytë në botë, pas industrisë së armatimit. E kujtoni heroin - trajnerin Kuka dhe Majlindën me shoqe dhe shokë, që e detyruan Putinin ta lejojë flamurin e Kosovës dhe himnin e Kosovës, të këndohet midis Rusesë. Duhet punë dhe dituri pra.

Ku e solli në anën tjetër Edita Tahiri, Hahim Thaçi, Isa Mustafa, Edi Rama me Baton Haxhiun, pozitën e Kosovës në Bruksel. Po këta kanë në tru plot dinakëri. Por nuk kanë dituri, nuk janë makra në diplomaci, as nuk mund të bërën kurrë. Populli i nderuar këta që sot po japin prapë premtime po frikësohen nga kuadrot e shkolluara. Ua shikoni shtabet zgjedhore dhe kompozicionin e deputetëve. Po, ata që tash thirren në veridiktin e Gjykatës Kushtetuese për Marrëveshjen e infektuar të Brukselit, është "mirë", sepse ka edhe më keq, por pse me ardhë

deri te 23 shkelle të Kushtetutës, kur në parti ai që negocionte i kishte juristët që dikur ishin administratorë e disa të tjerë të përtashëm, dikur ishin shoferë, që nuk e dinin (kam fakte) në provim çka është dominiumi, imperiumi dhe vetëvendosja. Zgjedhës të nderuar, zbuloni këto marifete (prof. dr. Ejup Statovci ka folur për këtë shëmtim juridik publikisht). Mendojeni kë po e votoni, kë po e delegoni të bëhet "diplomat", kryetar qeverie. Kur e pyeta profesorin e diplomacisë me famë botërore më 1975, pasi që magjistrov: çka do të thotë me qenë diplomat? Profa që i mësonte të gjithë diplomatët jo vetëm jugosllavë, më pati thënë: "Do të thotë më pak se ministër, më shumë se udbash". E pata vendos mos ta pranoj as pozitën e konsullit e as të diplomatit, edhe pse teoria e Din Batallit dhe Ramë Alihajdarit ishte në "nivel naiv britalisht kompromituese", që dikushi atëbotë ua kishte zili, për dijen e tyre: i pari kërcënues, i dyti lajkatar dhe shumë i sinqertë, që të dy të pashkollë të mirëfilltë spekulative.

Pse diplomatët tanë pa provime të diplomacisë (kam studiuar diplomacinë dy vjet në post-diplomë dhe do të frikësohesha po të isha konsull e jo ambasador me grada: "djali i dajës, apo çika e tezës" sot!!). Pse kryediplotatët tanë kurrë nuk ua përkujtuan në një tubim ndërkombëtar bashkëbiseduesve serbianë si e themeluat Republikën Serbe në Bosnje, pa qenë kurrë, e historia e Kosovës është më mirë e njohur se çdo shtet tjetër në Ballkan; pse kufijtë e Kosovës të tkurrën prej kujtdo qoftë, që në BE as nuk e dinë ku gjendet, e BE-ja vendos për fatin tonë. Pse përfaqësuesit e shtetit Kosovës e devalvuan veridiktin e GJND-së (Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë), e cila shpalljen e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 e cilësoi se nuk e shkelë të drejtën ndërkombëtare. E vërteta, Serbia mori ofensivë dhe na akuzoi në KS të OKB-së, prej kah Kai Aide dhe Kofi Anan e dërguan çështjen në GJND, por Serbia aty e mori autogol më 2010. Në bisedimet e Vjenës, Kosova e përfaqësuar nga një staf që ma shumë luftonte të promovohet me bërryla si individë sikurse në rastin e Rambujesë sesa të nxirret lufta e drejtë e UÇK-së në pozitë të paprekur, me tërë kapitalin që e kishte, sepse ishte faktor vendimtar. Kështu është në dokumentet e sirtarëve të ngjyrë limonit dje e kështu do të jetë nesër, kur të fillojnë bisedimet "teknike" nesër, po me kë?

(Vijon)

#PDK112

Merita  
Makolli

93

*Ndërtojmë të Ardhmen**Për Ty dhe Shtetin*

#PDK112

Shqiptar  
Demaçi

55

*Ndërtojmë të Ardhmen**Për Ty dhe Shtetin*

E rrallë

## Turistët duhet të paguajnë 1 000 dollarë për të hyrë në ishullin e dragonjve

Ishulli indonezian i Komodo, shtëpia e dragoit Komodo, nuk do të mbyllet për turistët vitin e ardhshëm. Por autoritetet kanë menduar vendosjen e një skeme anëtarësie prej 1 000 dollarësh. Në korrik u njoftua se ishulli do të mbyllet në janar për të mbrojtur dragonjtë dhe habitatin e tyre. Por qeveria



njoftoi se do ta vendoset skema e anëtarësisë. Aktualisht, turistët paguajnë rreth 10 dollarë për të hyrë në ishull.

FOTO E DITES




Një gaforre shihet në bregun e një liqeni ujëmbledhës afër Bochumit në Gjermani /AP/

E jashtëzakonshme

## I fshihej policisë prej 17 vitesh në një shpellë

Një 69-vjeçar që kishte 17 vite në arrati pasi kishte dalë nga burgu, kapet më në fund nga policia kineze, të cilët ia panë shpellën ku fshihej nëpërmjet dronëve. Song Jiang, një trafikant qeniesh njerëzore, kishte 17 vite që fshihej në malet e provincës Junan.



Ai ishte dënua për trafikim grash dhe fëmijësh, por u arratis nga burgu në vitin 2002. Policia nisi ta kërkojë sërish në fillim të shtatorit, kur morën një informacion për se ku mund të gjendej.

## BARSOLETA E DITËS



Pyet shoku shokun?

- A e njeh atë njeri?
- Po, ai së shpejti martohet dhe do të bëhet milioner.
- Pse çka po fiton me martesë?
- Një milion probleme!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

### Çdo ditë në ora 16:00 Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi;  
1 orë 40 min

**Rolet:** Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

Regjia: Josh Cooley



Në ora 18:00 dhe 20:00

### AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

**Rolet:** Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray



Çdo ditë në ora 22:00


### DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

**Rolet:** Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

Regjia: Michael Engler

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: **Kino ABC**.



**DASHI**

Dita e parë e këtij muaji do nisë me

shkrimet që lidhen me krijimin ose projektet që kanë të bëjnë me komunikimin.



**DEMI**

Ju jeni persona që e vlerësoni shumë

familjen dhe rrallë mund të mendoni të kundërtën.



**BINJAKET**

Disa libra që ju duken interesantë,

po ndryshojnë jetën tuaj në disa mënyra.



**GAFORRJA**

Zakonisht, ju besoni instiktet tuaja për

paratë, por sot besoni më shumë logjikën.



**LUANI**

Një mik ose një grup me të cilin

qëndroni mund të jetë duke ndryshuar jo vetëm personalitetin tuaj, por edhe jetën.



**VIJGJERESHA**

A keni qenë duke

menduar që të ndryshoni punë ose të provoni një profesion të ri? Nëse është kështu, sot është dita për ta provuar.



**PESHORJA**

Mund të pësoni një transformim

radikal të rutinës së përditshme.

**AKREPI**



**SOT MUND TË**

sulmohen vlerat tuaja.

Ndoshta një koleg në punë mund të bëjë gjëra që nuk ju duken etike dhe nuk doni të jeni më pranë tyre.



**SHIGJETARI**

Ditën e sotme do ta kaloni duke u

kujdesur me ortakëri, qofshin këto personale apo pune.



**BRICJAPI**

Sot do të përqendroheni tek hulumtimi

në fushat e paqarta të punës suaj.



**UJORI**

Do keni një ditë fantastike. Ju

do kryeni çdo detyrë që ju kërkohet dhe jeta në çift sot do të jetë shumë e zjarrtë.



**PESHQIT**

Disa punë që lidhen me

infrastrukturën e shtëpisë tuaj duhet të përfundojnë sot.

## Eva Marcille bëhet sërish nënë



**E**va Marcille është bërë sërish nënë. Ajo mirëpriti fëmijën e saj të tretë të premtën, djalin me emrin Maverick, konfirmon "Us Weekly". Macerick është fëmija i dytë

i Marcille me burrin Michael Sterling, me të cilin u martua vitin e kaluar. Pasi njoftoi se ajo ishte shtatzënë në muajin maj, Marcille zbuloi gjininë e foshnjës një muaj më vonë.

## Malika Haqq po pret fëmijë me ish të dashurin



**S**hoqja e ngushtë e Khloe Kardashianit, Malika Haqq, është shtatzënë me fëmijën e saj të parë dhe një burim tani ka zbuluar se kush është babai i fëmijës. 36-vjeçarja po pret fëmijë me ish të dashurin e saj, reperin O. T. Genasis,

raporton "Us Weekly". Çifti ishte në lidhje që nga fillimi i vitit 2017 para se të ndaheshin në vitin 2018 dhe në dukje duke rindërtuar romancën e tyre këtë vit. Në njoftimin për shtatzëninë, Malika nuk përmendi kush është babai i foshnjës së saj.



## Surpriza e Rita Orës në Javën e Modës në Paris, bampirësi për Kosovën

**E**veshur me të kuqe nga koka te këmbët, Rita Ora është shfaqur në "showroom"-in e Escada për ta festuar bashkëpunimin e saj më të fundit me firmën gjermane. Kjo ka qenë surpriza e këngëtares 28-vjeçare në Javën e Modës në Paris, madje ajo zgjodhi shoqatën e bamirësisë


"Women for Women International" për të dhuruar një përqindje të shitjeve të një modeli çante për Kosovën. "Koleksioni im kapsulë është dizajnuar për femrat që e dinë edhe fuqinë e gardërobës edhe të zërit të tyre", ka thënë Rita për linjën me 21 rroba e aksesore që u lansua të martën.

## Justin Bieberi ftoi një person të veçantë në dasmë

**J**ustin Bieberi ftoi ish të dashurën e vet në dasmën me Haileyn. E dashura e parë e këngëtarit 25-vjeçar, Caitlin Beades, mori pjesë në ceremoninë e tyre të hënën në Bluffton, Karolina e Jugut. Justini ishte në lidhje me Caitlin në vitin 2008 pasi u takua me të kur u transferua për herë të parë në Atlanta për të punuar me Usherin, sipas "E! News". Ata ishin në lidhje për një vit dhe Justini u bë i afërt me familjen e saj, përfshirë vëllanë e saj Christian, i cili, gjithashtu, ishte i pranishëm në dasmë. Ky gjest dëshmoi që Justini dhe Caitlini janë ende miq.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

## Feronikeli paralajmëron Llapin se pikët mbesin në Drenas

Sulmuesi kryesor i Feronikelit, Kastriot Rexha, e ka paralajmëruar skuadrën e Llapit se pikët e plota do të mbesin në Drenas. Ky derbi do të jetë jashtëzakonisht interesant për shikuesit, kurse ne do ta kemi përkrahjen nga 'Tigrat e zi' dhe me lojë të mirë do t'ia arrijmë qëllimin edhe në këtë ndeshje", ka thënë Rexha. Ndeshja e javës së tetë në mes të Feronikelit dhe Llapit zhvillohet nga ora 14:30



dy. Mesfushori Mentor Zhdrella ka thënë për gazetë se ndeshja që do të zhvillohet në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas do të jetë e vështirë për të dy klubet, kurse synim i "Niklit" është rezultati pozitiv. "Skuadra e Feronikelit është shumë cilësore dhe meriton respekt nga të gjithë, por ne do të shkojmë në Drenas për rezultat pozitiv. Do të jetë

vështirë për ta marrë maksimumin, por jo edhe e pamundur se Feronikeli nuk është skuadër e pathyeshme", ka deklaruar Zhdrella. Feronikeli pozicionohet në vendin e parë me 15 pikë, kurse Llapi është në pozitën e tretë me një pikë më pak. Sot zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera. Në Klinë takohen Dukagjini - Trepça '89 e

**IPKO SUPERLIGA**

Të mërkurën takohen:  
14:30 Feronikeli - Llapi  
14:30 Dukagjini - Trepça '89  
14:30 Ferizaj - Ballkani

Të enjten takohen:  
14:30 Drita - Vushtrria  
14:30 Flamurtari - Gjilani  
Prishtina - Drenica, takohen më 16 tetor

TABELA		
		PIKË
1. Feronikeli	7	15
2. Drita	7	14
3. Llapi	7	14
4. Ballkani	7	14
5. Prishtina	7	13
6. Gjilani	7	12
7. Trepça '89	7	9
8. Drenica	7	8
9. Flamurtari	7	7
10. Ferizaj	7	6
11. Vushtrria	7	5
12. Dukagjini	7	1

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Golashënuesi më i mirë i kampionatit të kaluar në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, Kastriot Rexha, shënoi dy gola në ndeshjen e fundjavës që Feronikeli e fitoi ndaj Ferizajit (5-0). Sulmuesi shtatëmbëdhjetëvjeçar për "Epokën e re" ka thënë se "Nikli" është gati ta arrijë fitoren e katërt radhazi në këtë edicion garash. Rexha e lavdëroi skuadrën e Llapit, por e paralajmëroi se tri pikët do të mbesin në Drenas. "Përballja me Llapin është një ndeshje shumë e rëndë-

sishme për ne, pasi kemi synim ta mbajmë pozitën e parë edhe pas xhiros së tetë. Nuk duhet mohuar fakti se Llapi ka një skuadër shumë të mirë dhe me përvojë, por ne jemi përparë për këtë ndeshje dhe synojmë fitore. Ky derbi do të jetë jashtëzakonisht interesant për shikuesit, kurse ne do ta kemi përkrahjen nga 'Tigrat e zi' dhe me lojë të mirë do t'ia arrijmë qëllimit edhe në këtë ndeshje", ka thënë Rexha. Edhe Llapi është duke kaluar nëpër një formë të mirë, pasi në dy ndeshjet e fundit ka marrë gjashtë pikë dhe ka shënuar shtatë gola dhe ka pranuar vetëm

në ndeshjen tjetër përballen Ferizaj dhe Ballkani. Dy ndeshje të tjera zhvillohen të enjten, kurse përballja në mes të Prishtinës dhe Drenicës është shtyrë për 16 tetor.

## Barça dhe Interi në kërkim të fitores së parë

**BARCELONË, 1 TETOR (ER)** - Barcelona sonte (e mërkurë) e pret skuadrën e Interit në Ligën e Kampionëve me synim që ta shijojë fitoren e parë në këtë garë pas një fillimi jo të mirë në La Liga, por edhe në Ligën e Kampionëve. Ndryshe nga Barcelona, Interi e ka nisur në mënyrë shumë të mirë edicionin e ri në Serinë A, por në ndeshjen e parë të grupeve ka zhgënjyer duke luajtur baras me Slavia Prague (1-1). Luis Suarez ka shënuar gol në fitoren e fundjavës ndaj Getafes dhe ka pasur paraqitje të mirë, prandaj pritshmëritë e Barçës nga sulmuesi Suarez janë të mëdha pasi Ousmane Dembele dhe Leo Messi janë në dyshim. Spanjollëve iu mungojnë edhe Ansu Fati, Samuel Umtiti dhe Jordi Alba. Një lojtar që ka nevojë për një paraqitje të madhe është Antoine Griezman, i cili ende nuk është adaptuar në skuadrën e Barcelonës që prej



transferimit nga Atletico Madridi. Trajneri Antonio Conte e ka të gjithë skuadrën në dispozicion për këtë ndeshje dhe nga fillimi pritet të luajë qendërbrojtësi Diego Godin, i cili gjatë verës iu bashkua Interit nga Atletico Madridi. Në Grupin F

ndeshja tjetër është në mes të Slavia Pragues dhe Borussia Dortmundit, kurse edhe këto dy klube janë në kërkim të fitores së parë. Këndelljen në Ligën e Kampionëve e kërkon edhe skuadra kampione e Evropës, Liverpool. "Reds" është

GRUPI E			GRUPI G		
18:55 Genk - Napoli 21:00 Liverpool - Salzburg			21:00 Leipzig - Lyon 21:00 Zenit - Benfica		
TABELA			TABELA		
		PIKË			PIKË
1. Salzburg	1	3	1. Leipzig	1	3
2. Napoli	1	3	2. Zeniti	1	1
3. Genk	1	0	3. Lyon	1	1
4. Liverpooli	1	0	4. Benfica	1	0
GRUPI F			GRUPI H		
18:55 Slavia Prague - Borussia D. 21:00 Barcelona - Inter			21:00 Lille - Chelsea 21:00 Valencia - Ajax		
TABELA			TABELA		
		PIKË			PIKË
1. B. Dortmund	1	1	1. Ajax	1	3
2. Barcelona	1	1	2. Valencia	1	3
3. Inter	1	1	3. Chelsea	1	0
4. Slavia Prague	1	1	4. Lille	1	0

paraqitur mirë në ndeshjen e parë ndaj Napolit, por në fund ka pësuar humbje. Kjo skuadër sonte e pret në

"Anfield" skuadrën e Salzburgut nga ora 21:00, derisa në orën 18:55 takohen Genk - Napoli.

## Në 'Minatori' takohen Trepça - Bashkimi

**PRIZREN, 1 TETOR** - Xhiroja e dytë e Superligës së Kosovës në basketboll zhvillohet në mesjavë ku do të ketë disa ndeshje shumë interesante. Të mërkurën përballen rivalët e vjetër Trepça - Bashkimi. Kjo do të jetë ndeshja e

parë për mitrovicasit në këtë edicion, pasi në xhiron e parë pushuan, derisa prizrenasit në javën e parë shënuan fitore kundër Lipjanit 107:57. Të mërkurën Sigal Prishtina takohet me Ponte Prizrenin, kurse të

enjten takohen Lipjani me Golden Eagle Yllin. Ndeshja Feronikeli - Rahoveci zhvillohet në një termin tjetër, sepse Vreshtarët luajnë në kualifikimet e FIBA Europe Cup. Peja pushon në xhiron e dytë.

**SUPERLIGA**

Të mërkurën takohen:  
17:00 Trepça - Bashkimi  
19:00 Sigal Prishtina - Ponte Prizreni

Të enjten takohen:  
19:00 Lipjani - Golden Eagle Ylli





## Marquezi përgatitet që ta festojë titullin në Tajlandë

BANGKOK, 1 TETOR - Të dielën në mëngjes me orën evropiane, Marc Marquez mund të shpallet zyrtarisht kampion i Moto GP për herë të 6-të në karrierë pikërisht në Çmimin e Madh të Tajlandës.

Spanjollit të Hondas i mjafton të marrë dy pikë më shumë se Andrea Dovizioso në ndalesën e radhës për të mbyllur edhe matematikisht çështjen titull, 4 gara para fundit të sezonit. "Kishim një

fundjavë fantastike në Aragon dhe jam i lumtur që fitova para tifozëve të mi. Dua të kem të njëjtin optimizëm dhe të njëjtën energji pozitive edhe për garën e kësaj fundjave në Tajlandë, në mënyrë

që të bëjmë një paraqitje fantastike. Qasja jonë nuk ndryshon pavarësisht prej rrethanave. Do të bëjmë të njëjtën punë për të qenë më të fortë të dielën", ka thënë Marquezi.



## Rahoveci sonete debuton në garat evropiane



RAHOVEC, 1 TETOR - Rahoveci - Cluj Napoca është sfida e parë për "Vreshtarët" në garat evropiane. Një natë historike, ku atmosfera pritet të jetë e jashtëzakonshme, ashtu siç dinë rahovecasit të krijojnë. Të mërkurën nga ora 20:30 zhvillohet ndeshja e parë në kualifikimet e FIBA Europe Cup, kurse më 9 tetor zhvillohet ndeshja e kthimit në Rumani. Skuadra rumune shihet si favorite, megjithatë Vreshtarët duan të tregojnë një lojë të mirë dhe të jetë një imazh i mirë për basketbollin

e Kosovës.

Trajneri i Rahovecit, Neven Plantak, ka folur për përballjen ndaj rumunëve. "Besoj se skuadra rumune është favorite, sepse ka një buxhet shumë më të madh se ne dhe dallimi është i madh. Për klubin tonë është e rëndësishme që të paraqitemi në garat evropiane dhe të jetë një imazh i mirë edhe për basketbollin e Kosovës. Sa i përket ndeshjes, duam të bëjmë një paraqitje të mirë. Megjithatë, Cluj është favorit dhe nuk ka dyshim. Për

klubin dhe tifozët është e rëndësishme të kemi paraqitje sa më të mirë. Rahoveci edicionin e kaluar ishte në finale të "play-off"-it dhe Kupës, kurse këtë edicion po marrim pjesë edhe në gara evropiane. Kjo është shumë e rëndësishme për ne dhe shpresoj në paraqitje të mirë, edhe pse e theksoj se Cluj është favorit absolut dhe ka buxhet shumë më të madh se ne", ka thënë trajneri Plantak për faqen zyrtare të FBK-së. Klubi ka njoftuar se çmimi i biletës është 2 euro.

## Drejt fundit karriera e Vettelit te Ferrari

BERLIN, 1 TETOR - Njeriu që zbuloi aftësitë e Sebastian Vettelit që në fillimet e karrierës në garat automobilistike i ka thënë pilotit gjerman se karriera e tij te Ferrari është në fundin e saj. Helmut Marko, personazhi influencues i Formulës 1 që i dha Vettelit kënaqësinë e debutimit me Toro Rosso në 2007-n para se t'i ngjiste me radhë shkallët deri në 4 tituj botërorë, ka një mendim radikal mbi atë se çdo të pasojë në javët e ardhshme. Pavarësisht se fiton më shumë se 40 milionë euro në sezon dhe konsiderohet pilot i parë te Ferrari, Sebastian Vettel vuajti urdhrat e ekipit duke u detyruar ta mbështesë yllin në ngjitje, Charl Lëklerk. Kjo situatë duket e pamendueshme muaj më parë, që një debutuesi t'i hapej rruga në dem të kampionit. "Ferrari nuk arriti të fitonte



pavarësisht se kishte makinën më të shpejtë dhe njeriun më të aftë. Skuadra sakrifikoi Sebastian Vettel dhe ai nuk ka më të ardhme atje". 32-vjeçari ka fituar vetëm 1 herë në 13 muajt e fundit dhe pavarësisht kontratës deri në

fundin e vitit 2020, me gjasë do të sakrifkohet nga skuadra italiane. Në kontrast me gjermanin, Lëklerk ka fituar 2 gara dhe është renditur 6 herë në Pole Position në edicionin e këtij viti në Formula 1.

### SHKURT

#### Ronaldo: E dua futbollin, por e mendoj jetën edhe pa të

Ylli i Juventusit, Cristiano Ronaldo, ka thënë se ai ende e dashuron futbollin, mirëpo ka filluar ta shijojë jetën jashtë kësaj loje. Portugezi po vazhdon të jetë në nivele të larta edhe përkundër se është 34-vjeçar. "Nuk jam një njeri i çmendur", ka thënë portugezi për "Sport Bible". "Nuk jam i pasionuar në stërvitje, jam i pasionuar në sukses, gjë që është e ndryshme. Unë ende e dua futbollin. E dua mbështetjen e tifozëve dhe njerëzve që e duan Cristianon. Nuk ka rëndësi moshë, gjithçka ka të bëjë me mentalitetin", ka thënë Ronaldo. "Në pesë vjetet e fundit kam filluar ta shijoj këtë proces dhe ta shikoj jetën jashtë futbollit, kështu që ende nuk e di se çfarë do të ndodhë në vitin tjetër apo pas dy vjetësh", ka shtuar Ronaldo.

#### Boca Juniorsi e dëshiron Ibrahimoviçin

